 6. Mundëson hartimin e projekt propozimeve për ti paraqitur për financim nëpërmjet Fondit Vjetor të Bashkisë për Fuqizimin dhe Zhvillimin e Komuniteteve.
 7. I paraqet Kryetarit të Bashkisë dhe Këshillit Bashkiak listën vjetore të përparësive të lagjes të miratuar nga Këshilli/ Kryesia për buxhetin vjetor të Bashkisë, të cilën e paraqet mbrenda muajit qershor.
 8. Kryetari i fshatit mund të thirret në Mbledhjet e Këshillit apo Komisioneve të Përhershëm, ose merr pjesë në to me nismën e tij/saj pa të drejtë vote, dhe ka të drejtë të shprehin mendimin e tij/saj në mbledhje për çështje që janë të lidhura me fshatin përkatëse.
 9. Kryetari i fshatit shpërblehet për punën që kryen, sipas kriterëve të përcaktuara nga këshilli bashkiak, në përputhje me legjislacionin në fuqi. pajiset me vulë dhe ka autoritetin të lëshojë vërtetime për fakte e të dhëna për banorët ose territorin e fshatit të tij, për të cilat ai është në dijeni, sa herë që kjo kërkohet nga bashkia, nga vetë banorët ose nga çdo institucion tjetër, në përputhje me Ligjin.
 10. Dërgon pranë Bashkisë ankesa për cilësinë dhe sasinë së shërbime publike të ofruara në territorin e lagjes/ fshatit, si dhe shqetësimet e komunitetit dhe biznesit për këto shërbime.
 11. Ndjek, sipas rastit, zbatimimin e projekteve të financuar nga Bashkia, apo aktorë të tjerë në pronë apo mjedise në pronësi të përbashkët dhe njofton Administratorin e NjA për problemet e vërejtura.

Neni 31

Përgjegjësitë e Këshillit dhe Ndërlidhësit Komunitar në lagje

1. Ndërlidhësi dhe Këshilli Komunitar mund të mbështesin funksionet e Bashkisë në lagjen, kanë të drejtë të kryejnë funksione dhe kompetenca të caktuara që mund t'u delegohen nga Këshilli Bashkiak, i cili vendos edhe për masën e financimit apo bashkëfinancimit për kryerjen e funksionit apo kompetencës së deleguar, si dhe mund të zbatojnë projekte në dobi dhe përfitim të komunitetit. Këshilli komunitar (Ligji 139/2015, neni 69). Këshilli Komunitar kujdeset për zhvillimin ekonomik vendor, përdorimin e burimeve të përbashkëta dhe sigurimin e harmonisë sociale në lagje dhe sipas përgjegjësi të përcaktuara nga Këshilli Bashkiak.
2. Ndërlidhësi komunitar i lagjes mund të thirret në Mbledhjet e Këshillit apo Komisioneve të Përhershëm, ose merr pjesë në to me nismën e tij/saj pa të drejtë vote, dhe ka të drejtë të shprehin mendimin e tij/saj në mbledhje për çështje që janë të lidhura me lagjen përkatëse.
3. Ndërlidhësi komunitar mund të shpërblehet për punën që kryen, sipas kriterëve të përcaktuara nga këshilli bashkiak, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 32

Detyrat e Ndërmjetësit/ Kryetarit të Fshatit

1. Kryetari i Fshatit / Ndërlidhësit Komunitar është drejtuesi i Këshillit Komunitar, dhe drejton dhe organizon punën e Këshillit Komunitar.¹⁵
2. Mbështet funksionet vetëqeverisëse të Bashkisë në lagje / fshat
3. Kryetari/ Ndërmjetësi kujdesen për zhvillimin ekonomik vendor, përdorimin e burimeve të përbashkëta sociale në fshat/ lagje.
4. Ndihmon në procesin e policimit në komunitet, ruajtjen e sigurisë publike dhe sigurimin e harmonisë sociale në fshat/ lagje.
5. Jep mendimin për gjendjen social ekonomike të familjeve në fshat/ lagje.
6. Bashkëpunon me administratorin e Njesisë Administrative për të gjitha çështjet që lidhen me problematikat dhe zhvillimin të komunitetit dhe territorit në lagje/ fshat.
7. Bazuar në vendimin e Kryetarit të Bashkisë, Kryetariose Kryesia e Fshatit mund të kryejë detyrat simëposhtë:
 - a) kujdesen për parandalimin e ndërhyrjeve të paligjshme në rrjetin e furnizimit me ujë të pijshëm dhe kanalizimeve të ujërave të bardha dhe ujërave të ndotura, të kanaleve mbrojtëse të zonave të banuara, sidhërrjetit të kanaleve të retësorë të ujërave të ndotura;
 - b) kujdesen për parandalimin e ndërhyrjeve të paligjshme dhe të çdo lloji të dëmtimit të rrugëve, trotuareve dhe hesheshëve publike në fshat;
 - c) administrojnë e varrezat e fshatit;

¹⁵ Ligji nr. 139/2015, neni 68

- d) kujdesen përruajtjen e pyjeve dhe kullotave, sidhetë burimeve natyrore.
8. Kryetari i Fshatit/ Këshillit pajiset me vulë dhe ka autoritetin të lëshojë vërtetime për fakte e të dhëna për banorët ose territorin e fshatit të tij/saj, përtë cilat ai/ajo është në detyrë të shprehë, saherë që kërkohet nga Bashkia, ngavetë banorët ose nga çdo institucion tjetër publik, në përputhje me ligjin.¹⁶
 9. Merr pjesë në grupet e punës në nivel lagje/ fshati, për përballimin e situatave nga fatkeqësitë natyrore, shëndetësore, apo të tjera, sipas vendimit të Këshillit apo Kryetarit të Bashkisë.
 10. Lëshojë vërtetime të në shkruar dhe vulosur apo dokumentet e tjerapërtë cilat është i autorizuar me ligj apo me vendim të Këshillit Bashkiak.
 11. Drejton dhe organizon punën për zbatimin e projekteve që Bashkia i ka deleguaran

Neni 33

Detyrat e Ndërmjetësit/ Kryetarit të Fshatit si drejtues i Kryesisë/ Këshillit

1. Ndërlidhësit Komunitar është drejtuesi i Këshillit Komunitar, dhe drejton dhe organizon punën e Këshillit Komunitar.¹⁷
2. Përgatit rendin e ditës në bashkëpunim me Organin Ekzekutiv të Kryesisë/ Këshillit dhe të kryeson të gjitha mbledhjet e Kryesisë/ Këshillit
3. Thërret dhe organizon mbledhje të Kryesisë/ Këshillit
4. Mbikëqyr mbajtjen dhe zbardhjen e procesverbalit dhe mbledhjeve të Kryesisë/ Këshillit
5. Emëron Kryetarët e Komiteteve të Kryesisë/ Këshillit, që më pas miratohen nga Kryesia / Këshilli
6. Shërben si zëdhënës dhe përfaqësues i Kryesisë/ Këshillit
7. Përfaqësojnë Kryesisë/ Këshillit në mbledhjet e Ekzekutiv të Bashkisë dhe me Kryesisë/ Këshillat e tjerë, dhe më aktorë të tjerë
8. Mbikëqyr përgatitjen dhe deklaratave në emër të Kryesisë/ Këshillit
9. Informojë në mënyrë të vazhdueshme komunitetin për aktivitetet e Kryesisë/ Këshillit dhe të informon Kryesinë/ Këshillin për takimeve dhe aktivitetet e fshat/ lagje
10. Bën deklaratat para mediave mediave, në emër të Kryesisë/ Këshillit
11. Njofton mediat vendore për aktivitetet dhe ngjarjet e Kryesisë/ Këshillit
12. Krijon dhe të mban komunikim me banorë, organizatadhe biznese vendore në përpjekje për të rritur mbështetjen për Kryesinë/ Këshillin dhe përfshirjen e komunitetit në vendimarrjen Kryesinë/ Këshillin dhe Bashkisë.
12. Mban korrespondencën në emër të Kryesisë/ Këshillit.
13. Firmosë vendimet e Kryesisë/ Këshillit
14. Mbikëqyrfaqen e internetit Kryesisë/ Këshillit

¹⁶ Ligji nr. 139/2015, neni 71/4.

¹⁷ Ligji nr. 139/2015, neni 68

KAPITULLI III- NGRITJA EKESHILLIT KOMUNITAR

Neni 34

Inciativa e Ngritjes se Këshillit Komunitar

1. Këshilli Komunitar në lagje ngrihet dhe funksionon në bazë të iniciativës qytetare dhe organizohen mbi baza vullnetare.¹⁸ Si rregull, në çdo lagje krijohet një këshill komunitar. Këshilli bashkiak mund të vendosë që në një lagje të krijohen më shumë se dy këshilla komunitarë ose bashkimin e këshillave të dy apo më shumë lagjeve.¹⁹ Iniciativa qytetare për themelimin e një Këshilli Komunitar i paraqitet për vendimmarrje Këshillit Bashkiak nga jo më pak se një për qind (1%) e banorëve të lagjes.²⁰ Lagjia, si rregull, krijohet vetëm në territore me mbi 20 mijë banorë²¹. Minimumi i banorëve të një territor ku themelohet Këshilli Komunitar është 2,000/ 5,000/ 10,000 banorë.
2. Kryesia e fshatit zgjidhen nga banorët e fshatit. Këshilli Bashkiak përcakton me vendim numrin e përfaqësuesve

Neni 35

Përcakimi i Kufizimeve të Zonave të Lagjes së Qytetit

1. Për efekt të mbajtje së zgjedhjeve në territorin e Këshillit Komunitar, Këshilli Bashkiak përcakton zonat brënda lagjes dhe kufitë përkatës, por jo më shumë se katër/ pesë (4/ 5) zona për lagje. Zona ka 500/1000/2000/3000 banorë (në varësi të numrit të popullsisë votuese në zonë).
2. Në vendimin e Këshillit Bashkiak përcaktohen kufijt dhe hartat e zonave të lagjes.
3. Në përcaktimin e zonave Këshilli merr parasyh ndodhejne shakollave, institucioneve publike bashkiake
4. Territore te zonave qe janë parqe apo shehe publiekpublike

KREU I - ÇERTIFIKIMIT TË KESHILLAVE KOMUNITARE

Neni 36

Qëllimi i çertifikimit

1. Qëllimi i çertifikimit të Këshillit Komunitar është që të njohë zyrtarisht Këshillat e Komunitarë të zgjedhur, në mënyrë që ata të kenë një rol zyrtar këshillimor ndaj qeverisë bashkiake për çështjet e interesit të lagjes.
2. Të gjitha aplikimet për çertifikim do të paraqiten me shkrim në format e përcaktuara ngakjo rregullore dhe vendimet e tjera të Këshillit.

¹⁸ Ligji nr. 139/2015, neni 68/1.

¹⁹ Ligji nr. 139/2015, neni 68/4.

²⁰ Ligji nr. 139/2015, neni 20/1.

²¹ Ligji nr. 139/2015, neni 6/3.

Neni 37

Bordi i Çertifikimit të Këshillit Komunitar

1. Këshilli Bashkiak ngren Bordin e Çertifikimit të Strukturave Komunitare.
2. Bordi përbëhet nga pesë (5) anëtarë, tre (3) anëtarë të Këshillit Bashkiak, nga të cilën një anëtar i Komisionit të Përhershëm për Mandatet, Rregulloren, Zgjedhjet, Strukturat Komunitare dhe Peticionet, dy (2) këshilltarë të cilët përfaqësojnë dy grupet politike më të mëdha në Këshill, pozitë dhe opozitë, Drejtori i drejtorisë për fuqizimin dhe zhvillimin e komuniteteve, dhe Drejtori i drejtorisë juridike të bashkisë. Bordi respekton barazinë gjinore në përbërjen e anëtarësisë së tij. Anëtar i Komisionit të Përhershëm është kryetar i Bordit, ndërsa Këshilltari që i përket opozitë është zëvendëskryetar i Bordit.
3. Bordi shqyrton kërkesat që vijnë nga iniciativa qytetare për ngritjen e Këshillit Komunitar dhe vlerëson nëse iniciativa është paraqitur sipas kërkesave të vendosura nga Këshilli Bashkiak.
4. Bordi i paraqet Këshillit propozimet për ngritjen e Strukturave Komunitare. Propozimi shqytohët paraprakisht nga Komisioni i Përhershëm i Mandateve, Rregullores, Zgjedhjeve, Strukturave Komunitare dhe Peticionet.
5. Të gjitha mbledhjet dhe dokumentacioni i mbledhjes së Bordit janë të hapura për publikun. Bordi fton në mbledhjet e tij administratorët e NjA të Bashkisë, në varësi të çështjeve apo strukturave komunitare në territorin e NjA, si dhe ndërlidhësit komunitarë në detyrëpër dëgjesa publike apo pyetje.
6. Rregullat e mbledhjes së Këshilli do të shërbejnë si udhëzuese për mbledhjet e Bordit. Mbledhja e radhës të Bordit thirret nga Kryetari i Bordit, dhe në mungesë dhe me autorizim me shkrim, nga zëvendëskryetari i Bordit. Mbledhjet u njoftohen anëtarëve nga Kryetari i Bordit, apo në mungesë ngazëvendëskryetari i Bordit, jo më vonë se 5 ditë pune nga data e mbajtjes së mbledhjes. Mbledhja e Bordit dokumentohet në procesverbalin e mbledhjes, i cili mbahet nga një prej punonjësve të sekretariatit të Këshillit. Bordi haton një raport vjetor të veprimtarisë së tij, i cili nënshkruhet nga Kryetari i Bordit dhe ai paraqit Mbledhjes së Këshillit.
7. Bordi mund të mbajë takime të hapura apo dëgjesa publike, nëse e sheh të nevojshme për të marrë komente, propozime, informacione apo dëshmi në lidhje me iniciativën qytetare të paraqitur. Bordi përdor rregullat e Këshillit për komunikimin me publikun, si udhëzues për mbajtjen e takimeve të hapura apo dëgjesave publike.
8. Vendimet e Bordit merren me shumicën e anëtarëve të pranishëm.
9. Bordi pranon, shqyrton dhe kthen përgjigje për peticionet apo ankesat drejtuar Bordit që lidhen me vendimmarrjen e Bordit.

Neni 38

Procesi i Çertifikimit

1. Bordi për Çertifikimin e SK vlerëson nëse kërkesat për çertifikim i plotësojnë të gjitha kërkesa dhe kriteret e përcaktuara më poshtë në këtë nen.
2. Pasi të paraqitet një kërkesë për çertifikimin të Këshillit Komunitar, aplikimi do të mbahet nga Ddrejtoria e fuqizimit të komuniteteve për një periudhë prej 20 ditësh pune.

Gjatë kësaj periudhe, drejtorja vlerëson aplikimin për çertifikim për të përcaktuar nëse kërkesa i plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga Këshilli. Në fund të periudhës së 20 ditë pune, nëse është paraqitur vetëm një aplikim që përshkruan kufijsh për një Këshill Komunitar së propozuar dhe nëse aplikacioni është i plotë sipas vlerësimit të drejtorise, ajo ia përcjell Bordi/ Komisioni për shtyrzim, dhe njoftoni për këtë aplikuesin.

3. Nëse Drejtorja nuk arrin të vlerësojë aplikimin brenda periudhës kohore të prej 20 ditësh, drejtorja ia përcjell, aplikimin menjëherë dhe pa rekomandim Komisionit të Këshillit për shqyrtim.
4. Nëse Drejtorja merr dy ose më shumë aplikime për çertifikim brenda 20 ditëve të përmendura në punë, të cilat identifikojnë kufijtë të njëjtë, të ngjashëm ose të mbivendosi të Këshillit Komunitar, drejtorja kontakton aplikuesit mbivendosi, dhe I front ë bien dakort prër të paraqitue nje aplikim të përbashkët. Aplikantët do të kenë 20 ditë pune nga data kur u është bërë njoftimi për të zhvilluar një kërkesë të unifikuar.
5. Nëse konsensusi arrihet në çdo kohë brenda kësaj periudhe 20 ditë pune ose në çdo kohë gjatë një periudhe kohore të zgjatur, periudha e marrëveshjes përfundon dhe të gjitha aplikimet do të shqyrtohen dhe vlerësohen nga drejtorja
6. Kërkesa për çertifikimine iniciativës qytetare për ngritjen e Strukturës Komunitare do të plotësojë minimumi kërkesat e mëposhtme:
 - a. Parashtruesit e kërkesës do të duhet të mbledhin jo më pak se 200 dhe jo më shumë se 500 nënshkrime.
 - b. Nënshkrimet duhet, në masën maksimale të mundshme, të pasqyrojnë grupin më të gjerë të palëve të interesuara të komunitetit, si banorë, pronarë banesash, qeraxhi, pronarë biznesesh, të rinjë, mësues, mjek, persona të profesioneve të ndryshme (format aplikimi në shtojcën nr. _____)
 - c. Aktithemeluese, përfshirëinformacionin e mëposhtëm.
 - (i) Emrin e StrukturësKomunitare
 - (ii) Anëtarësia e palëve të interesit dhe bordi drejtues
 - (iii) Akti themeluese përcakton se anëtarësia e Strukturës Komunitare është e hapur për të gjithë palët e interesuara të komunitetit brenda kufijve të zonës së propozuar për Strukturë Komunitare.
 - (iv)
 - d. Me marrjen e njoftimit nga Komisioni se peticioni është verifikuar, parashtruesit e qarkullojnë peticionin për nënshkrimin e mbështësve.
7. Akti themelues përfshinë venddodhjen e zyrës të Bordit Drejtues dhe një metodë për zgjedhjen ose zgjedhjen e rregullt të anëtarëve si Bordit Drejtues.

Neni 39

Procedura e aplikimit për Çertifikim

1. Të gjitha aplikimet për çertifikimi e një Këshilli Komunitar i drejtohen Këshillit Bashkiak dhe regjistrohen në zyrën e protokollit të Bashkisë. Sekretari i Këshillit ia përcjellë aplikimin Drejtorisë për fuqizimin dhe zhvillimin e komuniteteve, dhe kërkon opinion me shkrim për miratimin apo jo të, bashkë me arsyet e përkatëse.

2. Aplikantët janë përgjegjës për paraqitjen e të gjitha dokumenteve të kërkuara të nevojshme për të shayrtuar dhe verifikuar përputhshmërinë me kërkesat e Bashkisë.
3. Aplikimi duhet të ketë the name, adresën, ID dhe kontaktet cel dhe email të aplikuesit.
4. Çdo aplikim do të shoqërohe me një letër të shprehjes së interesit të nënshkruar nga grupi që ka aplikuar për certifikimin e Këshillit Komunitar të propozuar.
5. Drejtorisë për fuqizimin dhe zhvillimin e komuniteteve do te sigurojë të gjitha të dhënat e nevojshme për shqyrtimin e aplikimit, si të dhënat për popullsinë e lagjes, hartat etj.
6. I gjithë komunikimi me Bordin/ Komisionin në lidhje me shqyrtimin e përputshmërisë së aplikimit do të bëhet me Drejtorisë për fuqizimin dhe zhvillimin e komuniteteve.

Seancat dëgjimore për Certifikimit e Këshillit Komunitar

1. Njoftimi për datën e dëgjësës publike i bëhet aplikuesit sëpaku 15 ditë para datës së seancës dëgjimore. Nëse është e mundur, dëgjesa mbahet brenda territorit që mbulon këshilli komunitar i propozuar.
2. Të gjitha dokumentet apo prezantimet që do të paraqiten aplikuesi i dërgohen drejtorisë nga aplikuesi jo më vonë se dhjetë (10) ditë pune para datës së dëgjësës.
3. Kryetari Komisionit hap seancën e degjimorepublikedhedeklarontitullin e aplikimit
4. Drejtori drejtorisë për fuqizimin e komuniteteve paraqet raportin në lidhje me aplikimin, dhe i pergjigjet pyetjeve të anëtarëve të Komisionit.
5. Kryetari Komisionit fton aplikantin (ët) të paraqesin çështjen e tyre në çfarë domënyreqëata e gjykojnë të përshtatshme.
Kryetari Komisionit kërkonet aplikuesit të deklarojnë nëse dosja është e plotë dhe nëse ka kundërshtime për provat e përfshira në dosje. Prezantimi i aplikantit do të kufizohet në gjithsej pesëmbëdhjetë (15) minuta, dhe me pas i pergjigjet pyetjeve të anëtarëve të Komisionit, në lidhje me materialin e paraqitur nga aplikantit ose faketet dhe të dhënat e përfshira në raportin e stafit.
6. Kryetari Komisionit fton anëtarët e publikut të paraqesin idëshmitë e tyre.
Anëtari i publikut që dëshiron të drejtohet Komisionit nëmbështetje të aplikimit, ka maksimumit tre (3) minuta, os në një afat të rregullor që Kryetari e gjykonte të përshtatshëm, për të dhënë komente. Koha totale e caktuar për komentet nëmbështetje të aplikacionit do të kufizohet në një maksimum prej 20 minutash dhe e njëj kohë është në dispozicion për të dëgjuar komentet nga anëtarët e publikut që kundërshtojnë certifikimin e aplikimit.

Neni 40

Mikqyrja e Strukturave Komunitare

1. Komisioni për Mandatet, Rregulloren, Zgjedhjet, Strukturat Komunitare do të mbikqyr në mënyrë periodike sistemin strukturave Komunitare në Bashki.
2. Komisioni mba seanca dëgjimore publike për të kërkuar kontribut nga Strukturat Komunitare në lidhje me shqetësimet, çështjet dhe problemet që duhet të adresohen dhe të hartojë politika për të përmirësuar politikën dhe programet për fuqizimin e strukturave komunitare.

Neni 41

Vlerësimi Vjetor

1. Drejtoria për fuqizimin dhe zhvillimin e komuniteteve bën në vlerësim vjetor të sistemit të Kryesive dhe Këshillave. Departamenti për të bërë një rishikim dhe vlerësim vjetor të sistemit të Këshillit të Fqinjësisë. Si pjesë e politikë së saj të mbikëqyrjes. Drejtoria harton nje liste treguesish të performances e cila miratohet nga Këshilli Bashkiak.
2. Bordi i Çertifikimit të Këshillave Komunitarë do të paraqesë komente e veta ne lidhje me raportin vjetor, ne mbledhjen e Komisionit të Përhershëm për Mandatet, Rregulloren dhe Strukturat Komunitare.

Neni 42

Shqyrtimi i Aplikimit për Çertifikim

1. Bordi/ Komisioni aprovon ose kundërshton aplikimet e certifikimit të Këshillit Komunitar në përputhje me ligjin dhe këtë Rregullore, dhe bazuar në prova dhe dokumentet e paraqitura nga Aplikuesi. Bordi/ Komisioni i kërkon aplikuesit plotësimin edokumenteve, nëse është e nevojshme.
2. Njoftimi zyrtar i vendimit të Bordit/ Komisionit, u komunikohet me shkresë aplikuesve por jo më vonë se 10 ditë pune pas dëgjësës publike që mban Bordi.
3. Vendimi i bordit i kalon për shqyrtim mbledhjes më të parë të radhës së Këshillit Bashkiak. Këshilli dëgjon raportin dhe propozimin e Bordit, raportin dhe propozimin e Komisionit të përhershëm, si dhe dëgjon për 5 minuta komentet e grupit aplikues dhe 5 min (nese ka) komentet e personave që janë undër aplikimit. Këshilli vendos për miratin, mos mirartin apo shtyrjen e miratimit të aplikimit në mbledhjen më të parë të radhës ku Këshilli Bashkiak duhet të shprehet përfundimisht për miratimin apo mos miratimin e aplikimit. Në rast refuzimi aplikuesi mund të drejtohet gjykatës administrative.
4. Rishqyrtimi i një vendimi për mos dhënjen e Çertifikimit mund të bëhet mbas një periudhe prej tre (3) muajsh për shkak se veprimi i Këshillit ka qënë i keqinformuar apo këshilluar ose Aplikuesi ka paraqitur Këshilli Bashkiak informacioneshtesë apo rrethanat ligjore apo tjerë që kanë ndryshuar.

Neni 43

Anullimi i Çertifikatës së Këshillit Komunitar

1. Anullimi i Çertifikatës së Këshillit Komunitar mund të jetë vullnetar ose jo vullnetar, dhe mund të ndodhë për një sërë arsyesh. Nisma për Anullimin e pavullnetshëm të Çertifikatës mund të bëhet nga Bashkia si rezultat i vlerësimit të fakteve që provojnë se Këshilli Komunitar ka dëshuar në zbatimin e kërkesave të kësaj Rregulloreje.
2. Deçertifikimi vullnetar mund të silltet nga vetë Këshilli i Komunitar për një sërë arsyesh duke paraqitur një kërkesë të nënshkruar të paktën nga tre (3) anëtarë të Këshilli i Komunitar të cilët kërkonjë deçertifikimin.

Neni 44

Anullimi Vullnetar i Çertifikimi

1. Këshilli Bashkiak mund të anultojë çertifikimin e një Këshilli i Komunitar bazuar në konstatimin se Këshilli i Komunitar ka dështuar të tregojë aftësinë për të përbushur funksionet dhe përgjegjësitë ligjore dhe të kësaj rregulloreje dhe se Këshilli i Komunitar nuk dëshiron ose nuk është në gjendje të zbatojë ligjet në fuqi. Propozimi mund të bëhet nga Kryetari i Bashkisë, mbas vlerësimit të bërë nga Drejtoria për fuqizimin dhe zhvillimin e komuniteteve, si dhe nga Komisioni i Përhershëm për Mnatate, Rregulloren, Zgjedhjet, Strukturat Komunitare dhe Peticionet.
2. Vendimi merret nga Këshilli Bashkiak dhe i njoftohet Këshillit Komunitar brenda 10 ditëve nga marrja e vendimit.
3. Këshilli i Komunitar mund të kërkojë vullnetarisht anulimin e çertifikimit. Kërkesa mund të paraqitet Këshillit Bashkiak mbas vendimit të Këshilli i Komunitar, apo nga Ndërmjetësi Komunitar. Këshilli i Komunitar apo Ndërmjetësi publikon kërkesën, për një periudhë prej 15 ditësh për reagime dhe komente të komunitetit të lagjes.
4. Kryetari i Këshillit ia dërgon kërkesën Kryetari i Bashkisë, i cili ia përcjell Drejtorisë për fuqizimin dhe zhvillimin e komuniteteve, për vlerësim.
5. Drejtoria e shqyrton kërkesën mbas përfundimit të afatit 20 ditor të publikimit të kërkesës dhe pasi ka marrë reagimet dhe komentet e publikut apo të anëtarëve të Këshilli i Komunitar, dhe mbas mbajtjes së dëgjësës publike nga Bashkia për këte çështje. Mbi bazë të këtij vlerësimi Kryetari i Bashkisë i propozon Këshillit Bashkiak pranimin apo refuzimin e kërkesës, jo më vonë se 15 ditë nga mbarimi i afatit 20 ditor të publikimit të kërkesës, përse kohë paraqitësit e kërkesës dhe Kryetari i Bashkisë nuk bien dakord për zgjatjen e këtij afati, gjë e cila dokumentohet me shkresë. Këshilli Bashkiak vendos për pranimin apo refuzimin e kërkesës së Këllimit Komunitar.
6. Këshilli i Bashkisë shqyrton kërkesën nëse Këshilli Komunitar apo Ndërmjetësi, sjell dokumente sin ë vazhdim: 1) evidence të proceset e përdorura për konsultimin e kërkesës më komunitetin dhe përfshirjen e komunitetit në procesin e vendimmarrjes, 2) provat që palët e interesuara janë anketuar në lidhje me kërkesën, 3) prova që tregojnë se Këllimit Komunitar apo Ndërmjetësi ka publikuar kërkesën në minimum tre vende publike në lagje, në faqen e internetit të Bashkisë dhe në faqen e internetit të vetë Këshillit Komunitar; dhe 4) evidencë që vendimi i Këshillit Komunitar për t'i kërkuar Këshillit Bashkiak anulimin e çertifikimit, është marrë pas publikimit për 15 ditë, në lagje dhe faqet e internetit të bashkisë dhe Këshillit Komunitar, të projekt vendimi për anulimin e çertifikimit.

KREU II - ADMINISTRIMI I PROCESIT ZGJEDHOR

Neni 45

Administrimi i Zgjedhjeve

1. Procesi i zgjedhjes së Kryesive dhe Kryetarëve të Fshatrave (Ligji 139/2015, neni 70/5) dhe i Këshillave dhe Ndërlidhësave Komunitarë mbikëqyret nga Këshilli Bashkiak.

2. Këshilli me vendim ngen Komisionin për Monitorimin e Zgjedhjeve të Strukturave Komunitare në nivle Bashkie. Komisioni ka pesë (5) anëtarë dhe përbëhet nga: Kryetari i Këshillit apo i autorizuari prej tij, Kryetari i komisionit të përhershëm për mandatet, rregulloren, zgjedhjet dhe strukturat komunitare, një këshilltar nga opozita më e madhe në Këshillin Bashkiak, Zëvendëskryetari i Bashkisë dhe Administratori i NjA të caktuar nga Kryetari i Bashkisë. Komisioni i paraqet Këshillit Bashkiak raportin e monitorimit të zgjedhjeve, jo më vonë së 10/ 15 ditë nga përfundimi i zgjedhjeve në secilin fshat/ lagje.
3. Këshilli zgjedh për çdo fshat/ lagje një Komision Monitoriminë nivel fshati/ lagje të përbërë prej tre (3) antarësh, nga të cilë dy (2) janë Këshilltarë, që i përkasin grupeve të ndryshme politike në Këshill, dhe një punonjës i administrates së Bashkisë i emëruar nga Kryetari i Bashkisë. Anëtarët e Këshillit që janë banorë të një fshati apo lagje preferohen të jenë anëtarë të Komisionit të Votimit në atë fshat apo lagje.
4. Për çdo qëndër votimi ngrihet Komisioni i Qendrës së Votimit. Kandidati për Strukturat Komunitare. Kandidatët nuk mund të jenë anëtarë të Komisionit të Qendrës së Votimit, por në çdo rast mund të jetë vëzhgues.
5. Këshilli me vendim ngen dhe përcakton anëtarët e Komisionit të Votimit për Anëtarët e Kryesisë/ Këshillit Komunitar. Komisioni i Votimit përbëhet nga tre (3) anëtarë: një Punonjës I sekretariatit të Këshillit, Administratori i NjA ku ndodhet fshati / lagjia, një anëtar i pavarur (mësues apo drejues i një institucioni arsimor në fshat/ lagje, drejtues i një OJF-je, jurist, një banorë me reputacion i lagjes/ fshatit por që nuk është anëtar i Kryesisë / Këshillit Komunitar në detyrë), i cili përzgjidhet nga _____.

Neni 46

Përgatitja se zgjedhjeve të Këshillave Komunitarë dhe Kryesisë së Fshatrave

1. Dhjetë (10) ditë pune përpara organizmit të zgjedhjeve të Kryesisë se Fshatrave, Këshilli Bashkiak informon banorët e çdo fshatrave për rolin, funksionet, organizimin dhe detyrat e Këshillit dhe Ndërlidhësi Komunitar dhe të Kryetarit e Kryesisë së Fshatit, sipas një kalendari takimesh publike të miratuar nga Këshilli Bashkiak. Ky proces informimi organizohet nga Sekretari i Këshillit në bashkëpunim me Administratorët e Njërive Administrative dhe koodinatorin e Bashkisë për njoftimin dhe konsultimin publik. Një grup 2 deri në 4 Këshilltarësh (sipas vendimi të Këshillit), dhe që i përkasin grupeve të ndryshme politike në Këshill, merr pjesë në secilin takim publik.
2. Bashkiapërgatitfletët e votimit me emrat e kandidatëvetëcertifikur.
3. SeciliKomisionhartonnjëraport, sipasformatittëmiratuarngaKëshilli, dhebrenda 5 ditëpunengapërfundimiizgjedhjeveiadërgonKomisionitpërMandatet, RregullorendheLigjishmërinë, sidhepërdijeniKryetarittëKëshillit. KomisionitpërMandatet, RregullorendheLigjishmërinë.
4. Brenda dhjetë (10) ditëpune, ngamarrja e raporteve ngaKomisionet e Monitorimit, KomisionitpërAdministrimineZgjedhjeveharton, diskutondhemiratonraportin e zgjedhjeve, dhesipasformatittëmiratuarngaKëshilli, përKëshillatdheNdërlidhësatKomunitarëdheKryetarët e Kryesitë e Fshatrave, dheiadërgonKryetarittëKëshillitpërt'japërcjellëKëshillittëBashkisëpërshqyrtim.

5. Këshilli me vendimpercakton numrin e anëtarëve të Kryesisë për çdo fshat dhe për çdo lagjet e fshatit që të përfaqësojë lagjen në Kryesinë e fshatit, sidhe për çdo lagjet e qytetit.
6. Këshilli me vendimpercakton datat dhe vendet ku do mbahen votimet, për secilin fshat/ lagje.
7. Lista e zgjedhësve për çdo fshat sigurohet nga Bashkia dhe shpallet dhjetë (10) ditë përparatë së zgjedhjeve në një godinë publike në fshat kryesisht në shkollën e fshatit, dhe nëse është e pamundur, në mjediset e një biznesi private në qendër të fshatit.
8. Bashkia mundëson dokumentacionin dhe materialet zgjedhore, sikurse të votimit, fletët e votimit, dokumentin e procesverbalit të mbledhjes, etj. Vulosja e fletëve të votimit bëhet me vulën e Bashkisë.
9. Proçesi i votimit është i hapur dhe Sekretari i Këshillit njofton dhe fton media për pasqyrimin e procesit zgjedhor.
10. Policia bashkiake është e prezente në mjediset ku kryhet votimi, gjatë procesit zgjedhor.

Neni 47

Komisioni për Administrimin e Zgjedhjeve

1. Komisionit për Administrimin e Zgjedhjeve për SK përbëhet nga pesë (5) anëtarë dhe kryesohet nga Sekretari i Këshillit.
2. Anëtarë të komisionit janë zëvendëskryetari i Bashkisë, drejtori i drejtorise juridike, drejtori i drejtorisë për fuzizimin dhe zhvillimin e komuniteteve, juristi i sekretariatit të Këshillit Bashkiak.
3. Detyrat e Komisionit janë:
 - a. Organizimi i zgjedhjeve dhe sigurimi i materialeve zgjedhore
 - b. Përpunimi dhe certifikimi i aplikacioneve për kandidatët për SK;
 - c. Dizajnimin, shtypjen dhe mbledhjen e fletëve të votimit;
 - d. Çertifikimi dhe publikimi i rezultateve të zgjedhjeve;
 - e. Përditësimi i faqes së internetit të bashkisë me të dhëna dhe informacini për zgjedhjet dhe kandidatët;
 - f. Përpunimi i kërkesave për regjistrimet e kandidatëve;
 - g. Përpunimi i listës së pagave të punonjesit që do angazhohen për administrimin e zgjedhjeve;
 - h. Përzgjedhja e qendrave të votimit
 - i. Trajtimin e ankesave përparregullsinë të zgjedhjeve.

Neni 48

Përzgjedhja e Qendrave të Votimit

1. Komisioni i Administrimit të Zgjedhjeve merr parasysh kriteret e mëposhtme për të përzgjedhur Qendrat të Votimit:
 - a. Hapësirë e mjaftueshme për të akomoduar regjistrimin dhe votimin;
 - b. Struktura e mbyllur që mundësojnë qasjen e personave me aftësi të kufizuara;
 - c. Parkim mjaftueshëm për votuesit;

- d. Qasje në tualete për punëtorët e sondazhit;
 - e. Afërsia me transportin publik;
 - f. Të jetën e disponueshme për të gjithë ditën e zgjedhjeve, afro 10 orë;
 - g. Vendndodhja neutrale për palët e interesuara dhe kandidatët.
2. Nëse vendet nuk janë të disponueshme ose nuk respektojnë kriteret më lart, Komisioni do të përzgjedhë një vendndodhje alternative, duke përfshirë, por jo duke u kufizuar, në objektet në pronësi të Bashkisë.

Neni 49

Orari i Votimit

1. Qendrat e votimit hapen në orën 9:00 dhe mbyllet në orën 18:00. 9:00
2. Komisioni Administrativ i Zgjedhjeve uantëdrejtë të zgjasë orarin e votimit, nëse do të jetë e nevojshme.

KREU III - KANDIDATET PËR ANËTAR TË KRYESISË / KËSHILLIT KOMUNITAR

Neni 50

Kriteret e Kandidatit për Anëtar të të Kryesisë / Këshillin Komunitar

1. Moshë minimale e votuesve që legjitimohen të votojnë për Këshillin Komunitar është tetëmbëdhjetë (18) vjeç në ditën e votimit.
2. Kriteret që duhet të plotësojë kandidati për t'u pranuar në procesin zgjedhor.
 - a) Të jetë banor i regjistruar i lagjes/ fshatit në të cilën kërkon të zgjidhet, prej të paktën 10 vitesh,
 - b) Të jetë mbi 18 vjeç,
 - c) Të ketë minimalisht arsim të mesëm dhe/ose arsim profesional të barazvlefshëm,
 - d) Të mos jetë shpallur me vendim gjyqësor të formës së prerë si i pazoti për të vepruar,
 - e) Të mos jetë i dënuar për vepra penale, me vendim të formës së prerë në 10 vitet e fundit në Republikën e Shqipërisë,
 - f) Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për vepra penale të turpshme sipas nenit 108 e vijues të Kodit Penal,
 - g) Të mos jetë i punësuar në administratën e Bashkisë ku është banor apo në drejtimin apo menaxhimin e lartë të institucioneve apo ndërmarrjeve në varësitë Bashkisë,
 - h) Të mos jetë dënuar me burgim me vendim të formës së prerë, jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për kryerjen e veprimeve apo mosveprimeve që përbëjnë vepra penale, sipas përcaktimeve të bëra në Ligjin nr. 138 datë 17.12. 2015.²²
 - i) Të mos jetë nën një proces gjyqësor si akuzuar për një veprë të rëndësishme penale.

²² Ligji nr. 138 datë 17.12. 2015 "Për Garantimin e Integritetit të Personave që Zgjidhen, Emërohen ose Ushetrojnë Funksione Publike".

- j) Të mos ketë historidhe precedent të konflikteve në komunitet, të dëmtim të pronës publike apo të dhunës në familje.
3. Kriteret bëhen publik në faqen e internetit të Bashkisë dhe publikohen zyrtarisht në secilën Njës të Bashkisë, së paku tre (3) muaj para datës së zgjedhjetë përcaktuara me vendim të Këshillit të Bashkisë.

Neni 51

Kufizimet e për Kandidim në Zgjedhje për Anëtarit të Kryesisë/ Këshillit Komunitar

6. Një person nuk mund të jetë anëtar i më shumë se një Kryesie/ Këshilli Komunitar.
7. Nuk mund të jenë anëtarë të të njëjtës Kryesie/ Këshilli personat e lidhur: bashkëshortë, prindër e fëmijë, vëlla e motër, si dhe vjehrrë e vjehrra me nusen e dhëndrin, kushërinjë të parë, dajallarë e xhaxhallarë me nipa dhe mbesa, halla e teze me nipër e mbesa.
8. Nëse kandidatët fitues në një Kryesie/ Këshill kanë lidhje familiare, sipas pikës një (1) të këtij neni, kandidati që ka marrë me shume vota merr mandatin, ndërkohë personi në lidhje familiare i hiqet mandati dhe vendin e zë kandidati i listës i cili ka marrë me shumë vota. Nëse të dy kandidatët fitues kanë të njëjtin numër votash, hidhet short nga Komisioni për Administrimin e Zgjedhjeve, dhe fituesit i jepet mandati.
9. Personat në lidhje familiare, sipas pikës një (1) të këtij neni, nuk mund të jenë anëtarë të njëkohshëm të disa Kryesive të Fshatrave apo Këshillave Komunitarë. Kandidati që ka marrë më shumë vota i jepet mandati, ndërsa familiarit të tij i hiqet mandati dhe vendin e zë kandidati i listës i cili ka marrë me shumë vota. Nëse të dy kandidatët fitues kanë të njëjtin numër votash, hidhet short nga Komisioni për Administrimin e Zgjedhjeve, dhe fituesit i jepet mandati.
10. Nuk mund të jenë anëtarë të Kryesisë/ Këshillit persona që mbajnë pozicionin e të zgjedhurit vendor në Bashki, zëvendës kryetar i bashkisë, sekretar i këshillit bashkiak, nëpunës civil të administratës së bashkisë, titullarë të institucioneve dhe drejtues të ndërmarrjeve në varësi të Bashkisë, Deputetë, Prefekti i Qakut, Kryetari i Këshillit të Qarkut, Ministër, zëvendës ministër, drejtues të agjencive qeveritare qendrore në nivel qarku, drejtues të institucioneve shtetërore kombëtare.

Neni 52

Dokumenet që Duhet të Paraqesë Kandidati

Çdo kandidat për anëtar të organit drejtues të Kryesisë së Fshati apo Këshillit Komunitar duhet të paraqesë pranë Këshillit Bashkiak:

1. Një deklaratatë të nënshkruar në formën e një letre angazhimit civil (formati në shtojcën) nëpërmjet të cilit kandidati shpreh angazhimin dhe qëllimet e tij për tu përfshirë në strukturën komunitare dhe për të kontribuar për komunitetin në mënyrë vullnetare. Ky dokument ka të cituar emrin, atësinë, mbiemrin, datëlindjen, gjininë, adresën e kandidatit dhe një kopje të dokumentit të identifikimit. Deklaratat e kandidateve që i është dërguar Bashkisë, janë dokumente publike.
2. Dokumentet zyrtare që provojnë se: a) nuk është i dënuar me burgim me vendim të formës së prerë nga gjykatat e Republikës së Shqipërisë, b) Të mos jetë i punësuar në administratën e Bashkisë ku është banor apo në drejtimin apo menaxhimin e lartë të

institucioneve apo ndërmarrjeve në varësitë Bashkisë, c) të mos jetë dënuar, jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për kryerjen e veprimeve apo mosveprimeve që përbëjnë vepër penale, sipas përcaktimeve të bëra në Ligjin nr. 138 datë 17.12. 2015.²³, d) të mos jetë në një process gjyqësor si i akuzuar për një vepër të rëndë penale.

3. Deklarata dhe dokumentet e tjera që kërkohen sipas këtij neni dërgohet dorazi apo me postë në adresën e Bashkisë.
4. Periudha e paraqitjes së deklaratës nga kandidati do të fillojë 65 ditë para ditës së zgjedhjeve dhe do të zgjasë 30 ditë. Kandidatët që vendosin të tërheqin emrin e tyre nga fletëvotimi, duhet ta bëjnë këtë me shkrim ose me email, jo më vonë se 30 ditë para ditës së zgjedhjeve.
5. Emri, deklaratata dhe fotografia e kandidatit të certifikuar do të shfaqen në faqen e internetit të Bashkisë, tek nënfaqja Strukturat Komunitare. Pasi një kandidat të tërhiqet, emri, deklaratata dhe fotografia e kandidatit do të hiqen nga faqja e internetit e Bashkisë. Sekretari i Këshillit do të publikojë listën e kandidatëve të certifikuar 20 ditë para ditës së zgjedhjeve.
6. Të gjithë kandidatët do të pajisen me udhëzimet përkatës për procesin zgjedhor, të cilat gjithashtu do të publikohen në faqen e internetit të Bashkisë.
7. Kandidati është përgjegjës për të identifikuar cilës SK i përket dhe për t'u informuar për aktet nënligjore dhe rregulloret që rregullojnë procesin e para, gjatë dhe pas votimit. Është përgjegjësia e kandidatit që të njohë dhe të zgjedhë vendin në SK për të cilën do të kandidojë.

Neni 53

Plotësimi i Formularit të Kandidatit

1. Çdo kandidat duhet të paraqesë informacionin sim ë poshtë:
 - a. Emri i Këshillit Komunitar ku do të kandidojë;
 - b. Emrin e pozicionit për të cilin do të kandidojë;
 - c. Informacionin kualifikues për dorë të përcaktuar statusin e palëstë të interesit (banor, banor dhe pronar e pasurisë të palujtshme, banor dhe pronar biznesi, banor dhe anëtarin e organizatës, iri/ e re).
 - d. Emri, Atësia, Mbiemri;
 - e. Data e lindjes;
 - f. Numri i telefonit;
 - g. Adresa e postë elektronike;
 - h. Adresa e postës;
 - i. Një fotografi dhe çdo dokumentacion i nevojshëm për të përcaktuar pozicionin në Kryesinë/ Këshillin Komunitar.
2. Ky informacion i kandidatit do të konsiderohet publik dhe do të publikohet në faqen e internetit të Bashkisë.

²³ Ligji nr. 138 datë 17.12. 2015 "Për Garantimin e Integritetit të Personave që Zgjidhen, Emërohen ose Ushtrajnë Funksione Publike".

3. Kandidatët duhet të paraqesin të gjithë dokumentacionin e nevojshëm brenda tre (5) ditëve pune para përfundimit të afatit të fundit të paraqitjes së aplikimit.

Neni 54

Kundërshtimi i Kandidatit

1. Çdo banorë apo një organizatë komunitare, jo-qeveritare apo fetare që ka zyrat apo zbaton programe në vazhdimësi në territorin e lagjes/ fshatit ka të drejtë të kundërshtojë kandidimin e një kandidati për anëtar të Kryesisë/ Këshillit.
2. Kundërshtimi paraqitet me shkrim tek Komisioni i Administrimit të Zgjedhjeve, sëpaku 10 ditë mbas shpalljes së listës së kandidatëve në faqen e internetit të bashkisë, tek ndërfaqja për strukturat komunitare.
3. Për tu pranuar, kërkesa për kundërshtimin e kandidatit duhet të shoqërohet me informacionin e mëposhtëm:
 - a. Emri e Mbiemri, numri i telefonit, email të kundërshtuesit,
 - b. Një arsye të përkundërshtimit të kandidatit,
 - c. Dokumentacioni që mbështet pretendimin e kundërshtimit.
4. Komisioni i përgjigjet kërkesë jo më vonë se 7 ditë nga regjistrimi i kërkesës në zyrën e protokollit të Bashkisë.
5. Emri dhe arsye të përgjigjes për janë të dhëna publik dhe shfaqen në faqen e internetit të bashkisë.

KAPITULLI IV – ZGJEDHJA E STRUKTURAVE KOMUNITARE NE FSHAT

Neni 55

Zgjedhjet e Kryesisë së Fshatit

1. Zgjedhjet e Kryesisë së Fshatit bëhen një herë në katër vjet, pas zgjedhjeve për Këshillin Bashkiak, dhe jo më vonë se tre muaj pas këtyre zgjedhjeve. Në rast mosrespektimi të këtij afati, deri në zgjedhjen e kryesisë së fshatit, Kryetari i Bashkisë emëron përkohësisht Kryetarin e Fshatit.²⁴
2. Anëtarët e Kryesisë zgjidhen nga banorët e fshatit. Zgjedhje në fshat janë të vlefshme nëse në të gjitha lagjet e fshatit kanë votuar më shumë se gjysma e banorëve me të drejtë vote të fshatit²⁵. Zgjedhjen bëhen përcjellësit të fshatit.
3. Përbërja e Kryesisë së Fshatit /Këshillit Komunitar duhet të respektojë ligjin për barazimin e grupeve të interesit dhe minoritetëve.
4. Zgjedhjet nuk mbahen njëherësh në të gjithë fshatrat, por sipas numrit (2) deri në tre (3) grupe fshatrash njëherësh. Këshilli Bashkiak përcakton kalendarin e mbajtjes së zgjedhjeve për Kryesinë e Fshatit.
5. Nëse zgjedhjet në një apo disa fshatra nuk janë të vlefshme, për arsye se numri i votuesve ka qënë më pak se 50+1 të numrit total të banorëve me të drejtë vote të regjistruar në zgjedhjet e

²⁴ Ligji nr. 139/2015, neni 70/4

²⁵ Ligji nr. 139/2015, neni 70/1.

funditvendore, zgjedhjetpëratëfshat/ra zhvillohenmbastremuajshnga data e zgjedhjeve. Nëseedhenëzgjedhjet e dytakanëmarrëpjesëmëpak se gjysma e banorëve me tëdrejtë vote, zgjedhjetmbahetmbasnjëperiudheprejgjashtëmuajngazgjedhjet e dyta, dhenëseedhenëzgjedhjet e tretakanëmarrëpjesëmëpak se gjysma e banorëve me tëdrejtë vote, zgjedhjetmbahetmbasnjëperiudheprejnë (1) vitinga data e zgjedhjetë treat, dhenëseedhenëzgjedhjet e katërtakanëmarrëpjesëmëpak se gjysma e banorëve me tëdrejtë vote, zgjedhjetmbahetmbasnjëperiudheprejnë (1) vitinga data e zgjedhjetëkatërta. Nëseedhenëzgjedhjet e pestanukmarrinpjesëmëshumë se gjysma e banorëve me tëdrejtë vote, KëshilliBashkiakvendosëmosbërjen e zgjedhjevebrendamandatitëKëshillit.

Neni 56

Mbyllja e Votimit dhe Numërimi i Votave

1. Qendrat e votimit mbyllën në orën e caktuar. Nëse edhe pas kalimit të këtij orari ka zgjedhës që presin në radhë, KQV-ja mbledh dokumentet e identifikimit të të gjithë zgjedhësve të pranishëm dhe i thërret ata me radhë për të kryer votimin. Asnjë zgjedhës tjetër nuk do të lejohet të votojë nëse nuk ka qenë në radhë në kohën e mbledhjes së dokumentit të identifikimit.
2. Pasi voton edhe zgjedhësi i fundit i pranishëm, KQV-ja merr vendim për mbylljen e votimit, duke shënuar në të edhe orën e mbylljes së votimit. Vendimi për mbylljen e votimit dhe ora e saktë e mbylljes së tij shënohen edhe në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KQV-së. Pas kësaj, në qendrën e votimit mund të qëndrojnë vetëm anëtarët KQV-së dhe Grupi Grupi i Monitoriti të Këshillit, dhe vëzhguesit e certifikuar që përfaqësojnë kandidaatt apo jo.

Neni 57

Vlerësimi i Votave, Nxjerrja e Rezultatit dhe Shpallja e Fituesve

1. Anëtarët e KQV bëjnë vlerësimin dhe numërimin e votave. Fitues/it paraparak shpallet/n kush merr numrin më të madh të votave të vlefshme në fshat. Sekretari harton tabelën e rezultateve e cila firmoset nga të gjithë anëtarët i KQV dhe Grupi Grupi i Monitoriti të Këshillit. Rezultati i votimi shpallet nga Kryetari i KQV, në prani të dhe Grupi Grupi i Monitoriti të Këshillit, dhe vëzhguesit e certifikuar që përfaqësojnë kandidatët, apo jo. Nësevotatjanëtëbarabarta, fituesicaktohet me short. ShortidrejttohetSekretarii KQV.
2. Nëse numri i votuesve në lagjen e fshatit është më i vogël se 50+1% e listës së votuesve në atë lagje, votimi quhet i pavlefshëm dhe kjo shënohet në Librin e Protokollit të Mbledhjes.
3. Komisioni i Administrimit të Zgjedhjeve (KAZ) administron tabelën e rezultateve të të gjithë KQV të secilës lagje të fshatit, dhe harton tabelën përmbledhëse të votuesve për çdo fshat dhe në total për fshatin.
4. Nëse numri total i votuesve është më i vogël se 50+1% e listës së votuesve në fshat KAZ shpall zgjedhjet në fshat të pavlefshme.
5. Nëse numri total i votuesve është më i madhe se 50+1% e listës së votuesve në fshat KAZ shpall zgjedhjet në fshat të vlefshme. Në këtë rast të gjithë kandidatët fitues në

lagjet e fshatit ku kanë votuar 50+1% e listës së votuesve, dhe të cilën kanë marrë 50+1 të votave të vlefshme shpallen fitues. Ndërkohë, gjithë kandidatët fitues në lagjet e fshatit ku numri i votuesve ka qënë me i vogël se 50+1% e listës së votuesve në atë lagje, nuk shpallen fitues.

6. Shpallja e rezultatit përfundimatar të zgjedhjeve bëhet nga KAZ jo më vonë se 15 ditë nga data e zgjedhjeve.
7. Vendimet e KAZ i dërgohen Këshillit Bashkiak dhe Kryetarit të Bashkisë.

Neni 58

Dokumentimi i Procesit të Votimit

1. Komisioni i Qendrës së Votimit (KQV) mban Libri i Protokollit të Mbledhjes për dokumentimin e procesit të votimit.
2. Në këtë procesverbal Sekretari i KQV shënon minimalisht datën e fillimi dhe mbylljes së votimit; numrin personave që kanë votuar në qendrën e votimit; numrin e fletëve të votim të marra në dorëzim dhe numrin e fletëve të votimit të papërdorura, numrin e fletëve të votimit të demtuara; vendimet e marra nga KQV gjatë ditës së votimit, votat e marrë nga secili kandidat, emrin, atësinë dhe mbiemrin e kandidatit/ëve fitues; vërejtjet e anëtarëve të KQV; problemet e ndodhura dhe parregullsitë e konstatuara gjatë procesit të votimit.
3. Libri i Protokollit të Mbledhjes firmoset nga tre (3) anëtarët e KQV dhe tre (3) anëtarët e Grupit të Monitorimit të Këshillit Bashkiak.
4. Listat e zgjedhësve me nënshkrimet e votuesve, kutitë e votimit, fletët e votimit, procesverbali i votuesve pjesëmarrës, librin e protokollit të mbledhjes, administrohen dhe ruhen nga Bashkia.

Neni 59

Ankesat për Procesin e Votimit

1. Ankesat për Procesin e Votimit paraqiten tek Komisioni për Administrimin e Zgjedhjeve, cili shprehet për pranimin apo refuzimin e ankesës, brënda shtatë (7) ditë pune nga rregjistrimi i kërkesës në zyrën e protokollit të Bashkisë. Ankuesi duhet të sjellë edhe evidenca apo dokumentacione për të provuar bazueshmerinë e ankesës
2. Nëse ankuesi nuk është i kënaqur me përgjigjen, mund t'ia drejtojë ankesën Këshillit Bashkiak, e nësë edhe me përgjigjen e Këshillit nuk është i kënaqur mund t'i drejtohet Gjykatës Administrative të Rrethit Gjygjësor.

KREU I– ZGJEDHJA E ANETAREVE TE KËSHILLIT KOMUNITAR

Neni 60

Mbajtja e Zgjedhjeve

1. Zgjedhjet mbahen njëherazi në të gjithë zonat e lagjes.
2. Këshilli Bashkiak siguron që anëtarët e Këshillit mbikqyrin procesin zgjedhor në të gjitha zonat, sipas shpërndarjes së bërë me vendim të Këshilli Bashkiak.
3. Votimi për anëtarët e Këshillit Komunitar bëhet i fshehtë ose hapur. Këshilli Komunitar merr vendim për rastet kur do të mbajë votim të hapur, dhe për këtë njofton Këshillin e Bashkisë dhe Drejtorinë për fuqizimin e komunteteve5 ditë ara dates së votimit, duke siguruar njëkohësisht që mjediset ku do të bëhet votimi i hapur të ketë hapsirën e nevojshme për të akomoduar votuesit.

Neni 61

Votimi

1. Votuesit që vijë në QV duhet të plotësojnë dokumentin "vetë konfirmues", nëpërmjet të cilit identifikojnë veten dhe konfirmojnë një nga pesë (5)statuset e votuesit.
2. Votimi i hapur bëhet në prani të të gjithë banorëve pjesëmarrës dhe votimi bëhet me ngritje dore. Numrimi i votave bëhet me zë të lartë nga njëri nga anëtarët e komisionit të votimit dhe rezultati shpallet menjëherë. Nëse votat janë të barabarta mes dy kandidatëve, hidhet short. Nëse e shumë se dy kandidatë kanë votatë barabarta, shorti bëhet me zgjedhjen e gurëve/ goglavenë njëkutitë padukshme, kunjëra ka ngjyrë të ndryshme ngatëtjera. Marrja e gurëve bëhet sipas rendit alfabetik të kandidatëve. Fituesi shpallet menjëherë dhe me zë të lartë. Pata votim të hapur secilit kandidat prezantim mundësi të flasë jo më shumë se 5 minutapër interesin dhe qëllimet e tij për të qënë anëtar i Këshillit. Kandidatiduhet të citojë një nga 5 pozicionet për të cilin ka aplikuar, dhenë së shpejtë për rikandidim apo për herëtë pare.
3. Çdo votues voton për kandidatët e të pesë kategoritë e kandidatëve, duke përzgjedhur nga lista e secilës kategorinë apo më shumë kandidatë. (teshihet)
4. Procedurat e tjeratë votimit dhe të administrimit të votimit do të jenë ato të zgjedhjeve të Kryesive të Fshatit, më sipër.

KREU II– ZGJEDHJA E DREJTUESVE TE STRUKTURAVE KOMUNITARE

Neni 62

Mbledhja e Parë e Këshillit Komunitar/ Kryesisë së Fshatit Z

1. Mbledhja e parë e Këshillit Komunitar/ Kryesisë së Fshatit thirret nga _____. Në mungesë të tij, nismën për thirrjen e mbledhjes së parë e merr Kryetari i Bashkisë.
2. Këshilli Bashkiak përcakton datat e mbajtjes së Mbledhjes së Parë të Këshillave Komunitare dhe Kryesive të Fshatit.

3. Sekretari i Këshillit Bashkiak njofton publikisht datat e thirrjesë mbledhjeve të para të Strukturave Komunitare jo më vonë se tre (3) ditë pune nga vendimi i Këshillit Bashkiak. Publikimi i njoftimit bëhet në faqen e interneti të Bashkisë, në minimumi një media vendore kryesore, dhe Administratori i NjA mundëson postimin e publikimeve në minimumi tre zona të lagjes/ fshatit.
4. Deklarimi i hapjes së Mbledhjes së Parë të bëhet nga Këshilltari Bashkiak që është deleguar nga Këshilli të përfaqësojë Këshillin në mbledhje. Mbledhja e parë e Këshillit, deri në zgjedhjen e Kryetarit të Fshatit/ Ndërlidhësit, drejtohet nga anëtari më i vjetër në moshë i Kryesisë/ Këshillit. Procesverbali i mbledhjes së parë mbehet nga punonjësi i Bashkisë i autorizuar, dhe firmoset nga anëtarët e Kryesisë/ Këshillit.
5. Në mbledhjen e parë Kryesia/ Këshilli:
 - a. Zgjedh Kryetarin e Fshatit/ Ndërlidhësin Komunitar
 - b. Miraton statutin/ rregulloren e funksionimit
 - c. Miraton procesverbalin e Mbledhjes.

Neni 63

Zgjedhja e Kryetarit të Fshatit dhe Ndërlidhësit Komunitar

1. Kryetari i fshatit zgjidhet nga radhët e anëtarëve të Kryesisë së Fshatit, dhe drejton dhe organizon punën e Kryesisë.²⁶ Ndërlidhësit Komunitar zgjidhet nga radhët e anëtarëve të Këshillit Komunitar, dhe drejton dhe organizon punën e Këshillit.²⁷
2. Këshilli Komunitar/ Kryesia e Fshatit, në mbledhjen e tyre të parë, miraton ngritjen e Komisionit të Votimit për zgjedhjen e Ndërlidhësit Komunitar/ Kryetarit të Fshatit, komision cili përbëhet nga tre (3) anëtarë të Kryesisë/ Këshillit, nga të cilët dy përfaqësues të grupeve të interesit dhe një banor.
3. Anëtarët e Komisionit të Votimit së bashku me Sekretarin apo personin që kryen detyrat e tij/saj, përgatisin fletët e votimit me emrat e kandidatëve të propozuar nga Këshilltarët.
4. Komisioni i Votimit përgatit raportin me rezultatet e votimit dhe ia përcjell Kryesuesit të Mbledhjesi cili/a shpall emrin e personit që votëbesohet si Kryetar/ Ndërlidhës.
5. Votimi për Ndërlidhësin Komunitar / Kryetarin e Fshatit, bëhet i fshehtë, dhe fitues shpallet kandidati që ka marrë numrin më të madh të votave të vlefshme, dhe nëse votat janë të barabarta, fituesi caktohet me short. Shorti drejtohet nga drejtuesi i mbledhjes së parë të Këshillit Komunitar.

²⁶ Ligji nr. 139/2015, neni 70/3.

²⁷ Ligji nr. 139/2015, neni 68.

KREU III - FUNKSIONIMI DHE VENDIMMARRJA E KESHILLIT

Neni 64

Mbledhjet e Kryesisë/ Këshillit Komunitar

1. Një mbledhje e Kryesisë/ Këshillit Komunitar është e vlefshme nëse shumica e gjithë anëtarëve janë të pranishëm në të njëjtën kohë dhe vend, për të dëgjuar, diskutuar dhe shqyrtuar çështje në interes të lagjes/ fshatit dhe brënda kompetencave të Kryesisë/ Këshillit.
2. Të gjitha Mbledhjet e Kryesisë/ Këshillit mbahen brenda territorit të fshatit/ lagjes, përveç se kur gjendja e emergjencës civile nuk e lejon. Mbledhjet nuk mbahen nëditë festash zyrtare dhenë ditën e zgjedhjeve politike, përveç se në rast të mbledhjes emergjente.
3. Mbledhjet janë të hapura, dhe përsa është e mundur transmetohen në faqen e internetit të Bashkisë, dhe i njoftohen publikut jo më vonë së 10 ditë nga data e mbledhjes. Njoftimi bëhet nga Kryetari Fshatit/ Ndërmjetësi, dhe në mungesë nga anëtari i autorizuar prej tij.
4. Mbledhjet e radhës së mbahen jo më rrallë se një dy në muaj, në javën e fundit të muajit, përveç se kur Kryetari i Fshatit/ Ndërlidhësi therret mbledhjen jashtë radhe. Një petition i banorëve, më jo më pak së 200/ 500 nënshkrime, mund të kërkojë mbajtjen e një mbledhje të Kryesisë / Këshillit.
5. Mbledhjet jashte radhe dhe mbledhjet emergjente mbahen me kërkesë të Kryetarit të Fshatit/ Ndërmjetësit, apo 1/3 anëtarëve të Kryesisë/ Këshillit.
6. Mbledhja hapet nga Kryetari/ Kryesuesi i Mbledhjes në orën e caktuar në rendin e ditës
7. Nëse Këshilli mban një mbledhje zyrtare në një orë dhe vend ndryshe nga ç'është njoftuar publikisht, Mbledhja nuk mbahet nëse nuk është njoftuar publikisht ora dhe vendi i ndryshuar i mbajtjes të kësaj mbledhjeje.
8. Kryetari i Fshatit / Ndërlidhësi mund ta shtyjë ose të mbyllë mbledhjen përpara kohe, në rastet e mungesës se kuorumit, kur rrethanat nuk e lejojnë vazhdimin normal të mbledhjes (konflikte, emergjencë natyrore apo tjetër), apo kur nuk ka përfunduar shqyrtimi i të gjitha pikave të rendit të ditës, dhe vendimi pasqyrohet në procesverbalin e Mbledhjes. Mbledhja vazhduese mbahet në vendin, ditën dhe orën e njoftuar në mbledhjen e shtyrë ose të mbyllur, dhe e njoftuar publikisht.
9. Në mbledhjet e Komiteteve, përsa është e mundur, zbatohen të njëjtat rregulla si në mbledhjet e Kryesisë/ Këshillit.
10. Anëtarët e publikut mund të regjistrojnë mbledhje me mjete audio- video, me kusht që të mos pengojnë zhvillimin normal të mbledhjes dhe nga vendi i dedikuar për publikun.
11. Për çdo paqartësi, në zhvillimin e mbledhjes, Kryetari i Fshatit apo Ndërmjetësi Komunitar, që drejtojnë mbledhjet e strukturave komunitare, i referohen rregullave të mbledhjes së Këshillit Bashkiak.

Neni 65

Procesverbali i Mbledhjes

1. Mbledhjet e Kryesisë/ Këshillit dhe të Komisioneve pasqyrohen në procesverbalin e mbledhjes, i cili mbahet nga një prej person i miratuar me vendim të shumicës sëanëtarëve të pranishëm në mbledhjes dhe firmoset , nga kryesuesi i mbledhjes, dy anëtarëtë Kryesisë/ Këshillit të pranishëm përgjatë gjithë mbledhjes dhe mbajtësi i procesverbalit.
2. Procesverbali i mbledhjes është i hapur për inspektim të banorëve dhe palëve të interesuara të lagjes/ fshatit.

Neni 66

Votimi në Mbledhjen e Kryesisë/ Këshillit

1. Anëtarët e Kryesisë/ Këshillit votojnë në mënyrë individuale. Anëtarët nuk mund ta delegojë të drejtën e votës. Këshilltari voton në një mbledhje zyrtare dhe të vlefshme të Këshillit, kur votimi kërkohet dhe kryhet sipas procedurave ligjore dhe atyre të parashikuara nga kjo rregullore e Këshillit. Votimi i Këshilltarit me telefon me video apo nëpërmjet video konferencës dhe i ndjekur nga të gjithë Këshilltarët njëkohësisht, nuk lejohet përveç në rastet e emergjencës civile. Anëtarët e pranishëm në Mbledhje dhe që nuk votojnë, pranojnë vendimin e shumicës.
2. Votimi në mbledhjen mund të bëhet i hapur apo i fshehtë. Votimi bëhet i veçantë për secilën çështje të rendit të ditës, dhe rezultatet e votimit deklarohen nga Kryetari të Fshatit/ Ndërmjetësit (kryesuesi) dhe regjistrohen në procesverbalin e mbledhjes.
3. Kërkesa për votim nominal ose të fshehtë formulohet në kohën që kryesuesi i mbledhjes mbyll diskutimet dhe deklaron se do të kalohet në votim. Çdo këshilltar ka të drejtën e propozimit për përcaktimin e mënyrës së votimit. Propozimi hidhet në votë pa debat.

Neni 67

Rendi i ditës dhe Njoftimi i Mbledhjes

1. Rendi i ditës i mbledhjes së Kryesisë/ Këshillit Komunitar propozohet nga Kryetari i Fshatit / Ndërlidhësi, miratohet në mbledhje dhe I shpërndahe anëtarëve bashkë me njoftimin e mbledhjes, jo më vonë së 5 ditë nga data e mbledhjes.
2. Rendi i ditës, bashkë me njoftimin, vendosen në minimum 3 vende publike.
3. Rendi i ditës i Mbledhjes së Këshilli të Fshatit dhe Këshillit Komunitar kanë kryesisht këto pika:
 - a. Zbatimi i projekteve dhe marrëveshjeve të miratuara nga këshillat dhe kryesitë e mëparshme.
 - b. Shqyrtimi i çështje të rendit të ditës e parashtruara në mbledhje,
 - c. Marrja e informimit mbi gjendjen e proceseve pjesëmarrëse, konsultimet publike dhe nismat e qytetarëve në lagje apo fshat
 - d. Çështje e kërkuara për shqyrtim nga Drejtoria e zhvillimit të komuniteteve.
 - e. Dëgjesa publike përpikat e rendit të ditës

- f. Njëseancë me pyetje, dëshmi, komente ehapurpërbanorëtdhepalët e interesuaratëlagjes/ fshatit, kumundtëbëhenpyetjepërçdoçështjegashtërendittëditësqë ka tëbëjë me lagjen/ fshatin.

Neni 68

Rishqyrtimi i Vendimit

1. Kryesia/ Këshilli mund të rishqyrtojë ose ndryshojë veprimet e tij përmes procesit të mëposhtëm Mocioni për rishqyrtim:
 - A. Para se Bordi të rishqyrtojë ndonjë çështje, Bordi duhet të aprovojë një Mocion për Rishqyrtim. Mocioni për rishqyrtim duhet të miratohet me veprim zyrtar të Bordit. Pasi miratimit të petitionit për rishqyrtim, Kryesia/ Këshilli mund ta rishqyrtojë, dhe marrë vendim për çështjen.
2. Mocioni për Rishqyrtim duhet të paraqitet, dhe miratohen gjatë të njëjtës mbledhje ku është marrë fillimisht vendimi, ose gjatë mbledhjes më të parë të radhës apo në një mbledhje jashtë radhe që mbahet jo më vonë së mbledhja më e parë e radhës.
3. Mocion për rishqyrtim mund të propozohet vetëm nga anëtari i cili më parë ka votuar në favor të vendimit të marrë.

Neni 69

Përgjegjësitë e Kryetarit të Fshatit/ Ndërmjetësit si Kryesues i Mbledhjes

1. Përgatit mbledhjes; dërgon ftesave për prezantuesit; përgatit rendit të ditë se mbledhjes;
2. Inkurajon i pjesëmarrjes së të gjithë anëtarëve në debat;
3. Kujdeset që mbledhja të zhvillohet sipas radhës së çështjeve dhe kohës së përcaktuar në rendin e ditës;
4. Sjell çështjeve e rendit të ditës në votim;
5. Sqaron vendimeve të marra nga Kryesia/Këshillinë mbledhjen e Këshillit Bashkiak apo Komisioni të Përhershëm përkatës, kur kjo i kërkohet;
6. Ndjekja e zbatimit të vendimeve të marra në bashkëpunim me Administratorin e NjA dhe me menaxherët e Bashkisë;
7. Kujdesetpërzbatiminiaktevenënligjoredheproceduravetëmbledhjes.
8. Kujdesetpërtransferimin e skedarëve, regjistrimevedhematerialevetëtjeratekdrejtuesiisapozgjedhur.

Neni 70

Procesi i Ankesave

1. Çdobanor apo grup interesi nëlagje/ fshat që kundërshton një vendim ose politikë, ose beson se është ndikuar negativisht nga një vendim ose politikë e Kryesisë/ Këshillit, mund të paraqesë një ankesë me shkrim tek Kryetari Fshatit/ Ndërlidhësi. Kryesia/ Këshilli do të marrë në shqyrtim dhe do ti përgjegjet ankuesit pasi ka marrë më parë

veprimet të duhura për adresimin e ankesës. Ky proces ankimi nuk ka parasysh ankesa të banorëve apo grupeve të interesit që thjesht nuk pajtohen me vendimin apo veprim të ndërmarrë nga Kryesia/ Këshilli, pasi këto ankesa mund të diskutohen në mbledhjet e Këshillit. Ky proces ankimi ka për qëllim të adresojë çështje që përfshijnë mosmarrëveshje procedurale (p.sh., mosrespektimi i Kryesisë/ Këshillit të kësaj rregullore apo statutit të SK).

2. Në rast se një ankesë nuk mund të zgjidhet përmes procesit që administrohet nga Kryesia/ Këshilli, ankesa mund të përcillet fillimisht Drejtorise së fuqizimit dhe zhvillimit të komuniteteve, e më pas ankuesi mund të drejtohet Këshilli Bashkiak.

Neni 71

Financat dhe Buxheti

1. Këshilli Komunitar krye funksione apo kompetenca të deleguar nga Këshilli Bashkiak si dhe zbaton projekte me financimin apo bashkëfinancimin e Këshilli Bashkiak, të cilat nuk mund të përdoren në asnjë rast për shpërblime apo pagesa për anëtarët e këshillit komunitar.²⁸
2. Kryesia dhe Kryetari i Fshatit / Këshilli dhe Ndërlidhësi Komunitar mund të shpenzojnë fonde vetëm për ushtrimin e rolit, funksioneve dhe përgjegjesive të dhëna atyre me ligj, me këtë rregullore apo me vendim të Këshillit Bashkiak, si dhe për zbatimin e projekteve për zhvillimin e komunitetit dhe territorit të lagjes/ fshatit, dhe në çdo rast vetëm për qëllime publike.
3. Kryesia / Këshilli kanë të drejtë të hartojë dhe zbatojë buxhetin e vet. Në këtë rast Kryesia / Këshilli duhet të punësojë, me kohë të plotë apo të pjeshme, një specialist financiar për menaxhimin financiar, që do të mbajë librin llogarive, hartojë, raportin financiar, bëjë pagesat dhe do t'i dërgojë deklaratat e llogarisë Departamentit, dhe detyra të tjera që lidhen me këtë pozicion.
4. Kryesia dhe Kryetari i Fshatit dhe Këshilli dhe Ndërlidhësi Komunitar nuk mund të shpenzojnë fonde publike për të lobuar palët e interesuara ose anëtarët e tjerë të publikut për të mbështetur qëndrimin e Kryesisë së Fshatit apo Këshillit Komunitar për rekomandimet që ato bëjnë.
5. Këshilli miraton udhëzuesin operacional për përdorimin e fondeve të Bashkisë nga SK.
6. Kryesia/ Këshilli mund të shpenzojnë fonde që lidhen me: shpenzimet operative dhe të zgjedhjeve; për komunikimin dhe shtrirjen e ndërveprimit me komunitetin; dhe projektet për zhvillimin e komunitetit.
7. Strukturat Komunitare duhet të kenë një sistem të menaxhimit dhe llogaridhënjes financiare që rregullon përdorimin e fondeve që përdoren nga Struktura Komunitare.
8. Kryetari i Fshatit/ Ndërlidhësi siguron që libri i llogarive është i hapur për aktorët e komunitetit të lagjes/ fshatit.
9. Vendosin një proces transparent që i mundëson secilit anëtar të Kryesisë/ Këshillit të rishikojnë librin llogarisve të SK.
10. Politikat e financimit të Bashkisë kërkon që të gjitha SKtë:

²⁸ Ligji nr. 139/2015, neni 69/2.

- a. Të miratojnë buxhin vjetor, sipas rregullave dhe standarteve financiare.
 - b. Të raportojnë rregullisht për financat në mbledhjet e Kryesisë/ Këshillit.
 - c. Të bëjnë auditime 4 mujore.
 - d. Të ngrejë komisionin për buxhet dhe financë cilimblidhës paku çdo tremuj.
11. Bashkia mundësoj rritjen e kapaciteteve të Kryesisë/ Këshillit dhe punonjësve të tyre për hartim dhe raportimin mujor e vjetor të zbatimit të buxhetit për projektet e financuar nga Bashkia. Bashkia harton manualin e aplikimit të Fondit Vjetor të Zhvillimit të Komuniteteve, sidhe siguron Kryesisë/ Këshillit formatet e hartimit dhe raportimit të zbatimit të buxhetit. Bashkia ofron trajnim për anëtarët e Kryesisë/ Këshillit dhe punonjësve të tyre në lidhje me hartim dhe menaxhimin e buxhetit.
 12. Ndërlidhësi komunitar dhe Kryetari i Fshatit mund të shpërblehet dhe të rimbursohen për punën që kryen, sipas kritereve të përcaktuara nga Këshilli Bashkiak, në përputhje me legjislacionin në fuqi²⁹.
 13. Këshilli/ Kryesia auditohet nga Bashkia për fondet dhënanga Bashkia, dhe sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi.

KREUIV- NDËRVEPRIMI I SK ME BASHKINE

Neni 72

Mbështja e funksionet Qeverisë së Bashkisë

1. Kryetari dhe Kryesia e Fshatit, si dhe Këshilli dhe Ndërlidhësi Komunitar kryejnë dhe mbështesin funksionet vetëqeverisëse të Bashkisë në fshatin dhe lagjen e tyre, dhe janë të detyruar të zbatojnë vendimet, urdhëresat dhe urdhrat e Këshillit dhe Kryetarit të Bashkisë.
2. Çdo projekt që zbatohet nga SK, me fonde nga jashtë qeverisë bashkiake, duhet të prezantohet në Bashki, dhe për sa është e kërkuar nga ligji dhe aket nënligjore dhe vendimet e Bashkisë, duhet të marrë miratimin nga Bashkia.

Neni 73

Ndërveprimi i SK me me Këshillin Bashkiak

Marrëdhënia e Këshillit Komunitar dhe Kryesisë së Fshatit me Këshillin Bashkiak

1. Ndërlidhësi Komunitar/ Kryetari i Fshatit mund të thirret në Mbledhjet e Këshillit Bashkiak ose merr pjesë në to me nismën e tij, dhe ka të drejtë të shprehë mendimin e tij apo të bëjë propozime për çështje që janë të lidhura me lagjen/ fshatin përkatës.
2. Këshilli Bashkiak mbikëqyr veprimtarinë e Këshillave Komunitarë dhe Kryesisë së Fshatrave. Komisioni i Përhershëm për Marrëdhënjet me Komunitetin, brenda muajit Maj, harton raportin vjetor për veprimtarinë e Këshillave Komunitarë dhe Kryesisë së Fshatrave, për vitin paraardhës, dhe ia paraqet Këshillit për shqyrtim.

²⁹ Ligji nr. 139/2015, neni 69/3, 71/6.

3. Komisioni i Përhershëm për Marrëdhënjet me Komunitetet organizon dy here në vit takim me të gjithë ndërlidhësit komunitarë dhe kryetarët e fshatrave për të diskutuar çështjet dhe problematikat e funksionimit të Këshillave Komunitarë dhe Kryesive të Fshatrave.
4. Marrëdhëniet e Këshillit Bashkiak me Ndërlidhësin dhe Këshillin Komunitarë, si dhe me Kryetarin dhe Kryesinë e Fshatit koordinohen nga Sekretari.

Neni 74

Ndërveprimi i Kryesisë / Këshillit me Kryetarin e Bashkisë

1. Zbaton urdhërat e nxjerra nga Kryetari i Bashkisë,
2. I dërgon Kryetarit të Bashkisë listën e prioriteve për investime në territorin e fshatit/ lagjes, të miratuara paraprakisht nga Kryesia/ Këshilli,
3. I dërgon kryetarit komentet dhe sugjerimet për buxhetin vjetor dhe paketën fiskale,
4. Lobon pranë Kryetarit të Bashkisë për zbatim të projekteve kulturore dhe mjedisore në fshat / lagje.
5. Këshillon Kryetarin e Bashkisë për veprime apo mosveprime në fshat/ lagje.

Neni 75

Ndërveprimi i Ndërlidhësit/ Kryetarit të Fshatit me Administratën e Bashkisë

6. Ndërlidhësi/ Kryetari të Fshatit komunikon në mënyrë të vazhdueshme dhe bashkëpunon me administratën e Bashkisë për të gjitha çështjet që i ndikojnë fshatit/ lagjes
7. Bashkëpunon me drejtorët e Bashkisë për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e projekteve të financuara nga Bashkia në lagje/ fshat.
8. Bashkëpunon me drejtorët e Bashkisë për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e projekteve zbatuara nga SK të financuara apo bashkëfinancuara nga Fondi i Zhvillimit të Komuniteteve të Bashkisën apo aktorë.
9. Komunikon me Drejtorinë e fuqizimit dhe zhvillimit të komuniteteve për të paraqitur problemet e komunitetit të lagje/ fshati dhe për aspektë të funksionimit të Kryesisë/ Këshillit Komunitar.
10. Komunikon me Drejtorinë e financës dhe buxhetit për aspektet e menaxhimit dhe raportimit financiar.

Neni 76

Ndërveprimi i Ndërlidhësit/ Kryetarit të Fshatit me Policinë Bashkiake

11. Ndërlidhësi/ Kryetari i Fshatit është në komunikim më Policinë Bashkiake për çështje të sigurisë publike, kontrollit të territorit, dhe zbatimit të akteve të Bashkisë në territorin e lagjes/ fshatit.
12. Njofton Shefine Policisë Bashkiake në rastet kur:
 - a. Ka problememe sigurie publike,
 - b. Ka ndërtime pa lejenë pronapublike,

- c. Vërehet dëmtim i zonave apo objekteve me rëndësi historike dhe arkeologjike,
- d. Kazënje pa leje apo dëmtim të pronës publike.
- e. Pengohet zbatimi i një urdhëri apo investimi të bashkisë,
- f. Në rastet e ndotjes së mjedisit në mjedise publike.
- g. Në rastet e bllokimit të rrugëve.

Neni 77

Veprimete Ndërlidhësit/ Kryetarit të Fshatit në Lidhje Shërbimet Publike

1. Monitoron investimet publike në territor dhe njofton Administratorin e NjA nëse ka ankesa nga banorët dhe bizneset për ndërhyrjet e entit investues në dëm të shëndetit apo pronave të banorëve dhe bizneseve.
2. Kryetari i fshatit kujdeset për administrimin e varrezave të fshatit.

Neni 78

Veprimete Ndërlidhësit/ Kryetarit të Fshatit në Lidhje Kontrollin e Territorit

1. Kryetari i Fshatit dhe Ndërlidhësi Komunitar bashkëpunon ngushtë me Administratorin e Njesisë Administrative në lidhje me kontrollin e territorit.
2. Gjatë punës për monitorimin e territorit Ndërlidhësit/ Kryetarit të Fshatit njofton Administratorin e NjA në lidhje me:
 - a. raste e hedhjes së mbetjeve nga banorët dhe biznese jashtë pikave të grumbullimit të mbetjeve.
 - b. dëmtimet e rrugëve, trotuareve, ndriçuesve publik, mungesat e pusëve, etj.
 - c. rastet e shpërthimit të tubacioneve të ujit të pijshëm dhe ujërave të zeza në sipërfaqen e tokës.
 - d. dëmtimet e brigjeve të lumëve dhe përrejtëve, që përbëjnë rrezik për banorët dhe bizneset.
 - e. hedhjen në territor të llumrave dhe solucioneve të lengshme, që përbëjnë rrezik për banorët dhe bizneset.
 - f. dëmtimet e strukturave ujëmbledhëse
 - g. ndërtime pa leje në territor

Neni 79

Veprimet e Ndërlidhësit/ Kryetarit të Fshatit në Lidhje Sigurinë Publike

1. Në rastet e emergjencave civile që vijnë nga bllokimi nga bora, përmytjet, shkarjet e dheut, çarjet e digave të ujëmbledhësve, bllokimit të rrugëve nga çarjet e rrugëve, emergjenca shëndetësore apo epidemia sëmundje virale apo tjetër.
2. Kryetari i Fshatit dhe Ndërlidhësi Komunitar informon Bashkinë dhe mobilizon burime njerëzore dhe material në komunitet për përballimin e situatës. Është pjesë e taskforcës të ngritur në fshat/ lagje për përballimin dhe rekuperimin mbas fatkeqësisë natyrore, shëndetësore apo tjetër

3. Ndhomon në identifikimin e familjeve në nevojë për ndihma financiare dhe material. Merr masa për ofrimin e asistencës në banesë ndaj shtresave në nevojë, në kushtet e epidemisë së shkaktuar, siç është rasti i familjeve/ individëve në nevojë, përfituesit e ndihmës ekonomike; personat me aftësi të kufizuara; personat, të cilët përfitojnë pension pleqërie.
4. Ndhomon në shpërndarjen e ndihmave dhe produkteve, ushqimore dhe joushqimore, për komunitetin, në bashkëpunim edhe me shërbimin e vullnetarëve.
5. Ndhimjnë në organizimin dhe zbatimin e evakuimit të detyruar për popullsinë e rrezikuar, të gjendjes së karantinës për popullsinë ose subjektet e prekura, në organizimin e punës për kontrollit të njëanshëm ose në bashkëpunim me komunitetin të banesave dhe objekteve private të demtuara apo për gjetjen e të mbijetuarve dhe të viktimave të fatkeqësisë, në kryerjen e shërbimeve funerale në rast fatkeqësish, në organizimin e procesit të eliminimit dhe të groposjes së detyruar të kafshëve dhe të çdo materiali tjetër që përbën burim infeksioni, epidemie masive, ndotjeje masive.³⁰

KREU V- KOMUNIKIMI DHE ANGAZHIMI I KOMUNITETIT

Neni 80

Komunikimi me Komunitetin

1. Kryetari i Fshatit/ Ndërmjetësi dhe anëtarët e Kryesisë/ Këshillit do të komunikojnë rregullisht me banorët dhe palët e interesit të komunitetit, si dhe do të sigurojnë që informacionet e SK shpërndahet në mënyrë të barabartë dhe në kohën e duhur.
2. Këshilli/ Kryesia do të përpiqet të organizojë dhe koordinojë të paktën dy komunikime masive në vit, çdo 5- 6 muaj përmes shpërndarjes të materialeve të shtypura, fletëpalosjeve, mesazhe me email tek grupet e interesit dhe organizatat, takime derë më derë, njoftime në vendet publike, stendat e informacionit, prezencë në median vendore të shkruar dhe audiovizive, deklarata për shtyp, ngjarje të komunitetit, në mënyrë që të zgjerojë mundësinë e njerëzve për të marrë pjesë në aktivitetet dhe punët e SK.
3. SK ka faqen e saj të internetit dhe meda e saj sociale, e cila mbështetet nga Bashkia.

Neni 81

Mobilizimi dhe Angazhimi i Komunitetit

1. Kryesia/ Këshilli do të prioritarizojë mobilizimin e grupeve në nevojë për të qënë aktiv, duke nxitur edhe angazhimin dhe mbështetjen e vullnetarëve për keto grupe.
2. Këshilli do të bëjë përpjekje të vazhdueshme dhe të bashkërenduara me Bashkinë dhe aktorët komunitarë për të rritur pjesëmarrjen dhe angazhimin e banorëve dhe grupeve të interesit në punët dhe aktivitetet e SK.
3. Kryesia/ Këshilli organizon sëpaku një konsultim me komunitetin për të diskutuar propozimin nëse në një lagje duhet të krijohen më shumë se dy këshilla komunitarë ose bashkimin e këshillave të dy apo më shumë lagjeve.

³⁰ Ligji nr. 45/2019, neni 42/2.

4. Kryesia/ Këshilli nxit dhe mobilizon banorët dhe palët e interesuara të marrin pjesë në takimet dhe konsultimet publike të organizuara nga Bashkia apo aktorë të tjerë, në lidhje buxhetin vjetor të Bashkisë, paketën fiskale, përcaktimin e prioritetit strategjik, planifikimin e zhvillimit të territorit, hartimin e planeve të shërbimeve publike, zbatimin e projekteve zhvilluese, shitjen apo dhënjen me qera të pronave bashkiake, zbatimin e projekteve dhe bërjen e investimeve me ndikim në mjedis, etj.
5. Këshilli/ Kryesia miraton planin vjetor dhe afatmesëm të Komunikimit dhe Angazhimit të komunitetit në aktivitetet dhe punët e SK dhe politikëbërje dhe ofrimin e shërbimeve të Bashkisë.

Neni 82

Etika në Punën e Strukturave Komunitare

1. Anëtarët e secilës Strukturë Komunitare do të respektojnë Kodin e Etikës të miratuar nga Këshilli Bashkiak.
2. Të gjitha ligjet në fuqi do të përbëjnë standartin minimal të etikës për Kryesinë/ Këshillin, Kryetarin e Fshatit dhe Ndërlidhësin.

Neni 83

Vetëvlerësimi i Strukturës Komunitare

1. Çdo Kryesi/ Këshill Komunitar i çertifikuar, me ndihmën e Drejtorisë për fuqizimin dhe zhvillimin e komuniteteve, siç kërkohet, do të anketojë banorët të paktën një herë në dy vjet, për të vlerësuar nëse Kryesia/ Këshilli ka përmbushur qëllimet e zbatueshme të përcaktuara këtu rregullorë apo në ndonjë dokumente të politikave të Bashkisë për strukturat komunitare.
2. Gjetjet e anketimit do të bëhen publik në faqen e internetit të Bashkisë.
1. Këshilli organizon brenda muajit Prill të çdo viti takim in llogaridhënës publik, ku prezanton raportin vjetor të veprimtarisë së Këshillit dhe bështetjen buxhetore për prioritetet zhvillimore të Bashkisë. Prezantimi bëhet nga Kryetari i Këshilli, sipas një formati të miratuar nga Këshilli. Takimi in llogaridhënës i njoftohet publikut 10 ditë para mbledhjes, dhe Sekretari fton media audiovizive vendore dhe kombëtare për të marrë pjesë në takimin publik të llogaridhënjes.

Neni 84

Llogaridhënja e Kryesisë/ Këshillit Komunitar

1. Kryesia /Këshilli miraton një grup treguesish të performancë për punën e saj/ tij.
2. Kryesia /Këshilli organizon brenda muajit Prill/Maj të çdo viti takim in llogaridhënës me komunitetin e lagjes/ fshatit, ku prezanton raportin vjetor të veprimtarisë së saj/tij. Prezantimi bëhet nga Kryetari i Fshatit/ Ndërlidhësi.
3. Takimi in llogaridhënës i njoftohet komunitetit 10 ditë para takimit, me shpallje në sèpaku 3 vende publike në lagje/ fshat, dhe në faqen zyrtare të internetit të Bashkisë.

Neni 85

E drejta e Informimit, Komunikimi dhe Marrëdhënjet me Publikun

1. Kryetari i Fshati dhe Ndërmjetësi, në zbatim të ligjit për të drejtën e informimit, duhet t'i përgjigjet një kërkesë për marrje informacioni, të dhëna apo dokumente brenda 10 ditëve nga data dorëzimi i kërkesës në strukturën komunitare.
2. Nëse të dhënat, informacionet apo dokumentet e kërkuara nuk i jepen kërkuarit, në shkresën e përgjigjes duhet përcaktuar baza ligjore për mos dhënjen e tyre.
3. Çdo Strukturë Komunitare ka faqen e saj të internetit.

Neni 86

Përdorimi i Vulës dhe Stëmës nga Strukturat Komunitare

1. Struktura Komunitare ka vulën e vet e cila mbahet dhe përdoret nga Kryetari i Fshatit/ Ndërlidhësi, apo nga një punonjësi SK i miratuar nga Kryesia/ Këshilli.
2. Vula përdoret edhe për lëshimin e vërtetimeve për fakte e të dhëna për banorët ose fshatin, për të cilat ka dijeni të plotë dhe është përgjegjës para ligjit.
3. Struktura Komunitare zhvillon stëmën e vet të cilën e përdorë në të gjitha korrespondencat, botimet, publikimet dhe ngjarjet.
4. Për dëmtimin ose humbjen e vulës Kryetari/ Ndërlidhësi njofton menjëherë Këshillin dhe Kryetarin e Bashkisë, dhe për këtë bën një deklaratë me shkrim.
5. Struktura Komunitare mund të përdorë edhe stëmën e Bashkisë nëse autorizohet nga Këshilli Bashkiak.
6. Kryetari i fshatit në mungesë të zyrës dhe kasafortës duhet ta ruaj vulën, në një vend të sigurt dhe të garantuar.

Neni 87

Ruajtja dhe Mirëmbajtja e Regjistrave

1. Librat e kontabilitetit, rregjistrat, procesverbalet, minutat e mbledhjeve dhe procesverbalet e mbledhjeve të Kryesisë/ Këshillit dhe të komisioneve të përhershme, mbahen në një vend ose në vendet e përcaktuara nga Kryetari i Fshatit/ Ndërmjetësi ose, në mungesë të një përcaktimi të tillë, në zyrën kryesore të Këshillit.
2. Drejtoria për fuqizimin dhe zhvillimin e komuniteteve mban të dhënat e fondeve të transferuar Strukturave Komunitare nga Bashkia dhe aktorë, dhe një kopje elektronike të vendimeve të marra nga Strukturat Komunitare, si dhe listën vjetore të projekteve të zbatuara apo në proces nga Strukturat Komunitare.

KREU VI. STRUKTURA TË TJERA ME BAZE KOMUNITARE

Neni 88

Zona e Përmirësimit të Biznesit

1. Zona e Përmirësimit të Biznesit (ZPB) është një organizatë jofitimprurëse me anëtarësi përfaqësues të bizneseve të zonës, ku Bashkia mund të marrë pjesë përkatësisht si anëtare ose si anëtare e organit vendimarrës, e që krijohet sipas legjislacionit për organizatat jofitimprurëse. Veprimtaria e ZPB ka si qëllim rigjallërimin e zonave të biznesit në Bashki, duke lehtësuar zhvillimin e tyre, rritjen ekonomike dhe zhvillimin e qëndrueshëm në ZPB përkatëse ku ka përqëndrim të lartë të biznesit të vogël, të mundësujë një qasje bashkëpunuese midis Bashkisë dhe sektorit privat në ofrimin, përmirësimin dhe shtimin e shërbimeve bashkiake.
2. Propozuesipërngritjen e ZPB janë: a) tëpaktën 5 (pesë) pronarëbiznesitënjësi vetregtare qëndodhennëZonën BID tëpropozuar;b) çdoorganizatëjofitimprurëseekzistuese me njëinterespublikpërkatësdhetëjustifikuarnëZonën BID;c) çdodhomëtregtie me njëinterespublikpërkatësdhetëjustifikuarnë ZPB;d) vetëBashkia, nëpërmjetKëshillitBashkiak. Kërkesa e nënshkruatnganishtëtarët (rastit a, b,c, d), dheshoqëruar me dokumentacioninzzyrtar, idrejtohetbashkisëbashkë me pikat e propozimit. KëshillitBashkiakmiratonoserefuzonpropoziminpër ZPB brenda 30 (tridhjetë) ditëshkalendari kenga data e marrjessëPropozimitpër ZPB apo ngandryshimiiPropozimitpër ZPB, nëseështëkërkuarpërmirësimiiPropozimitpër ZPB. Këshillimiratonanëtarësinë e Bashkisënë ZPB apo nëkëshillitkryesues të ZPB.
3. ZPB krijohetdhefunksiononpërnjëmandattëcaktuar, siçpërcaktohetnëProspektin ZPB përkatës, por nëçdorast me njëafat jo mëpak se 3 (tre) vjetdhe jo mëshumë se 7 (shtatë) vjet, me tëdrejtëripërtëritje. Pas përfundimittëmadatitë ZPB, ZPB ka tëdrejtëntëkërkojëngaPaguesit e Kuotëssë ZPB zgjatjen e afatitë ZPB dhemë pas konfirmiminpërkatësngaKëshillitBashkisë, sipastënjëjtaveproceduratëndjekurapërmiratiminifillestartë ZPB.
4. Menaxhimii ZPB bëhet sipasligjitpër “Zona e Përmirësimit të Biznesit”.

KAPITULLI III - FORUMI I DHE STATUTI I STRUKTURAVE KOMUNITARE

KREU I - FORUMI I STRUKTURAVE KOMUNITARE

Neni 89

Forumi i Ndërlidhësve Komunitarë dhe Krytarëve të Fshatrave

1. Në bashki ngrihet Forumi i Drejtuesve të Strukturave Komunitare, anëtarë të të cilit janë të gjithë ndërlidhësit komunitarë dhe krytarët e fshatrave.
2. Forumi është organanimë që diskuton çështjet dhe problemet e ushtrimit të funksioneve dhe detyrave të strukturave komunare, do të zhgjojë funksionimin e sistemit të SK dot'i paraqesë Këshillit Bashkiak dhe Kryetarit të Bashkisë propozimet për përmirësimet legjislative, forcim kapacitetesh, mbështetjen financiare dhe aspekte të bashkëpunimit mes strukturave komunitare dhe qeverisë bashkiake. SK llobojnë mbështetje për projektet dhe për fuqizim të SK.

3. Forumi shërben si një platformë për të ndarë praktika, eskperienca, nevoja, sfida dhe inovacione.
4. Forumi zgjedh bordin drejtues të forumit, i cili për përbëhet nga pesë (5) anëtarë, tre (3) kryetarë fshatrash dhe dy (2) ndërlidhës komunitarë. Anëtarësia e bordit respekton kërkesat e ligjit për barazinë gjinore. Bordi zgjedh kryetarin e Forumit për një periudhë 2 vjeçare, dhe me mbarimin e këtij afati bordi zgjedh kryetarin tjetër të forumit për një peridhë 2 vjeçare. Nëse për periudhën e parë 2 vjeçare kryetar forumi zgjidhet një kryetar fshati, në periudhnë e dytë zgjidhet një ndërmjetës komunitar.
5. Forumi mblidhet një herë në dy vjet dhe Bashkia mbështet me logjistikë dhe fonde mbajtjen e mbledhjes së Forumit.
6. Forumi ka 4 komitete: Komiteti për funksionimin dhe rregullat e strukturave komunitare, dhe financat, Komiteti për marrëdhënjet me Bashkinë dhe aktorët, Komiteti për marrëdhënjet me komunitetin, dhe performancën dhe llogaridhënen, dhe Komiteti për kontrollin e territorit dhe shërbimet publike dhe projektet. Dy komitete drejtohen nga kryetarë fshati dhe dy komitete nga ndërmjetës. Anëtarësia e komiteteve është e përzier me kryetarë fshati dhe ndërlidhës komunitarë. Anëtarësia e komiteteve respekton kërkesat e ligjit për barazinë gjinore. Komitetet mblidhen çdo gjashtë muaj. Raportet gjashtë mujore të secilit komitet i paraqiten Bashkisë dhe mbledhjes vjetori të forumit.
7. Forumi mund t'i propozojë Këshillit Bashkiak rekomandime për ndryshime të kufijve të lagjeve dhe fshatrave.

Neni 90

Statuti dhe Rregullorja e Strukturë Komunitare

1. Çdo Strukturë Komunitare harton dhe miraton statutin dhe rregulloren e vet, ku detajon autoritetin, strukturën dhe procedurat e punës së Këshillit dhe Ndërmjetësit Komunitar/ Kryesisë dhe Kryetarit të Fshatit.
2. Kryesia/ Këshilli mund të miratojë dispozita dhe rregulla më të detajuara, vetëm në plotësimin e kësaj rregulloreje dhe të rregulloreve apo akteve të tjera të miratuara nga Këshilli Bashkiak dhe që kanë efekt mbi Strukurat Komunitare. Dispozitat dhe rregullat shtesë nuk do të interpretohen për të ndryshuar ose zëvendësuar rregullat e kësaj rregulloreve dhe të rregulloreve apo akteve të tjera të miratuara nga Këshilli Bashkiak, të cilat kanë për qëllim të udhëheqin sjelljen e anëtarëve, si dhe zgjedhjet dhe procedurat e mbledhjes së Kryesisë/ Këshillit.
3. Nëse dispozitat e statudit dhe rregullat e detajuara të miratuara nga Kryesia/ Këshilli bien ndesh me aktet nënligjore, këtë rregullore dhe rregulloret apo akteve të tjera të miratuara nga Këshilli Bashkiak, do të prevalojnë këta të fundi. Rregullorja e Kryesisë/ Këshillit mund të miratohen, ndryshohen ose shfuqizohen me shumicë të thjeshtë votave të anëtarëve të Kryesisë/ Këshillit.
4. Një kopje e drafrit të statudit dhe rregullores i dërgohet Bashkisë për vlerësim. Drejtoria përfuqizimin dhe zhvillimin e komuniteteve dhe Drejtoria juridike e Bashkisë bën vlerësimin e rstatutit dhe i dërgon secilit Këshill Komunitar dhe Kryesi e Fshatit përmirësime e sugjeruara. Ndërmjetësi Komunitar/ Kryetari i Fshatit bëjnë reflektimet e sugjerimeve dhe mbas mbajtjes së një séance konsultimi publik me komitetin e lagjes/

fshatit e, paraqet për miratim. Kopje e miratuar e statutit dhe rregullores i dërgohet zytarisht Bashkisë.

Neni 91

Dispozita kalimtare

1. Ngarkohen Bashkia _____, Këshillat dhe Ndërlidhësit Komunitarë dhe Kryesitë dhe Kryetarët e Fshatrave për zbatimin e kësaj rregulloreje.
2. Kjo rregullore hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, neni 55, ligji Nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”.

SHTOJCAT

Shtojca nr. 1 Format aplikimi certifikimit të iniciativës qytetare për ngritjen e Këshillit

PETICION PER INCIATEN QYTETARE DREJTUAR

KESHILLIT TE BASHKISE _____

Adresa: Tel: Cel: Email:

1. Ne, të nënshkruarit banues të regjistruar të Bashkisë_____, të Qarkut_____, dhe banues në adresat e përcaktuara anash emrave tanë përkatës, duke qenë të barabartë me një përqind (1%)³¹ të numrit të përgjithshëm të banorëve të regjistruar të Bashkisë, me respekt kërkojmë që akti/vendimi i mëposhtëm të miratohet nga Këshilli i Bashkisë _____ ose, nëse nuk miratohet nga Këshilli i Bashkisë, kërkujmë t'i paraqitet për votim referendar banorëve të Bashkisë_____.

2. Baza ligjore të peticionit është neni 20/1 i Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisje vendore”,

3. Situata/Çështja që nxiti dorëzimin e këtij peticioni është:

4. Titulli i projekt aktit që propozojmë është si më poshtë:

(Këtu vendoset titulli i projekt vendimit të propozuar, duke siguruar që akti/ vendimi i propozuar nuk përmban më shumë se një lëndë dhe që lënda shprehet qartë në titull, dhe pastaj vendosni një nga dy fjalitë e paraqitura më poshtë. Titulli i peticionet duhte të jetë në çdo fletët të peticionit)

(Teksti i plotë i projekt aktit/vendimit është si më poshtë) ose

(Një kopje e plotë dhe e saktë e projekt aktit/vendimit i bashkëngjitet këtij Peticioni)

5. Deklaroj se unë e kam nënshkruar personalisht këtë peticion. Unë jam një banues i regjistruar i Bashkisë _____ dhe adresa ime e vendbanimit është deklaruar e saktë.

Nr.	Emri	Mbiemri	ID	Adresa	Firma
1					
2					
20					

6. Drejtuesi i peticionit

Emri _____ Mbiemri _____, ID _____

Firma _____

Tel: Cel: Email:

7. Dokumentet shoqëruese të peticionet janë (nëse ka):

a)

b)

³¹Ligji nr. 139/2015, neni 20/1.

Shtojca nr. 2: Model Strukturë e Statutit të Kryesisë/ Këshillit Komunitar

I. Emri i Strukturës Komunitare/ Fshatit

II. Qëllimi

III. Kufijtë

- 1: Përshkrimi i kufijve
- 2: Kufijtë e brendshëm të zonave të lagjeve/ lagjeve të fshatrave

IV. Palët e interesuara, banorët

V. Këshilli Komunitar/ Kryesia

- 1: Përbërja
- 2: Kuorumi
- 3: Veprimet zyrtare
- 4: Afatet e mandateve
- 5: Detyrat dhe fuqitë e Këshilli/ Kryesisë
- 6: Vende të lira
- 7: Mungesat
- 8: Pezullimi i anëtarit të Këshillit
- 9: Shkarkimi
- 10: Dorëheqja
- 11: Ndërveprimi me komunitetin

VI. Ekzekutivi i Strukturës Komunitare

1. Detyrat dhe fuqitë e Kryetarit të Fshatit / Ndërlidhësit
2. Përzgjedhja e zyrtarëve
3. Afatet e punës së zyrtarëve

VII. Komitetet dhe Detyrat

- 1: Komitetet e përhershme
- 2: Krijimi i komiteteve

VIII Mbledhje e Këshillit

- 1: Koha dhe vendi i mbledhjes
- 2: Përcaktimi i rendit të ditës
- 3: Njoftimi i mbledhjes
4. Llojet e mbledhjeve
- 5: Rishqyrtimi e vendimeve të Këshillit/ Kryesisë

IX. Financat

1. Mbajtjave llogarive
2. Auditimi
3. Kontratat
4. Raportet financiare

X. Zgjedhjet

- 1: Administrimi i Zgjedhjeve
- 2: Struktura e Këshillit/ Kryesisë dhe Votimi
- 3: Moshë minimale e votimit
- 4: Metoda e verifikimit të statusit të palëve të interesuara
- 5: Kufizime për kandidatët që kandidojnë për vende të shumëfishta

XI. Proçesi i ankesave

XII. Raportet

- 4: Vjetor
- 5: Periodik

XIII. Ndryshimet e Rregullores

XIV. Zbatimi i Rregullores, Akteve nënligjore

- 1: Trajnimet e detyruara, Rritja e kapaciteteve
 - 2: Vetëvlerësimi i Strukturës Komunitare
- A - Harta e Këshillit Komunitar
- B - Struktura dhe votimi i Këshillit

References:

Ligji nr. 139/ 2015

Ligjin nr.10019 datë 29.12.2008, Kodi Zgjedhor I Republikës Së Shqipërisë, I ndryshuar

USA “Neighborhood Councils Rules, Standards and Best Practices”, City of Los Angeles, - California.

USA, “Neighborhood Council 2016 Election Manual”, Department of Neighborhood Empowerment and the Office of the City Clerk, City of Los Angeles- California.

USA, “Neighborhood Council - How to Handbook”, City of Missoula, Office of Neighborhoods.

Neighborhood Council Training Manual, Legal Issues for Neighborhood Councils, Office of the City Attorney, City Attorney, City of Los Angeles 2006.

USA, Neighborhood Council Election Handbook - 2019, City of Los Angeles, - California.

Bashkia Vlorë, Rregullorja për Organizimin dhe Funkcionimin e Strukturës Komunitare në Fshat.

Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM), Strukturat Komunitare në Shqipëri, Manual, 2016.